

Mr. TAHIR FONIQI

**TIPAT**  
**E BIBLIOTEKAVE**  
**NË KOSOVË**

Prishtinë 2008

*MR. TAHIR FONIQI*  
*TIPAT E BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË*

*Botues*

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

BKUK: Botime të veçanta; 13

*Kryeredaktor i botimeve*

Prof. Dr. Sali Bashota

*Recensent*

Sylejman Pireva

*Lektor*

Nezir Selmani, prof.

*Dizajni dhe realizimi kompjuterik*

Hekuran Rexhepi

*Shtyp*

Shtypshkronja "Prograf" Prishtinë

MR. TAHIR FONIQI

# TIPAT E BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË

*1944-1986*

Prishtinë 2008

## PARATHËNIE

**B**ibliotekat në Kosovë e kanë traditën e tyre të hershme, rreth gjashtë shekuj, ku shquhet, sidomos, periudha pas Luftës së Dytë Botërore. Bibliotekat e para hasen në kisha, manastire, xhami, medrese, teqe etj., dhe datojnë nga shek XIV, pa i parë këtu edhe bibliotekat vetjake, të cilat mund të jenë edhe më të hershme.

Libri “Tipat e bibliotekave në Kosovë 1944-1986” paraqet historikun e shkurtër të bibliotekave, në këtë trevë, gjatë periudhës për të cilën bëhet fjalë këtu.

Rrjeti i bibliotekave në Kosovë, deri në mbarim të vitit 1986, arrin të zgjerohet në 594 biblioteka të pesë tipave kryesorë: Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, në cilësinë e bibliotekës së përgjithshme kombëtare, me seli në Prishtinë, 189 biblioteka publike, 28 biblioteka universitare, 55 biblioteka speciale e 321 biblioteka shkollore.

Lënda e këtij libri është ndarë në pesë kaptina: 1. Formimi i rrjetit të bibliotekave, 2. Struktura e koleksioneve të bibliotekave, 3. Struktura e përdoruesve (lexuesve) të koleksioneve të bibliotekave, 4. Kuadrot bibliotekare dhe rregullimi profesional i koleksioneve bibliotekare, 5. Veprimtaria arsimore e kulturore e bibliotekave. Brenda kaptinave janë dhënë edhe disa nënkaptina, të cilat i plotësojnë kaptinat veç e veç.

Në libër, sikurse do të bjerë në sy, kjo gjatë leximit, janë shmangur mangësitë e shfaqura brenda bibliotekave, që nga zanafilla e tyre, politika kuadrore, furnizimi i bibliotekave me material bibliotekar, terminologjia bibliotekare etj. Prandaj puna më e madhe mbetet tejkalimi i këtyre vështirësive. “Ne dimë të gjitha përgjigjet: ajo që nuk dimë janë çështjet”, ka thënë Arçibald Makllash, bibliotekar kryesor në Bibliotekën e Kongresit Amerikan.

Nisur nga natyra e punimit, në fusnota, janë dhënë informacione të shkurtëra për numrin e shkollave (fillore e të mesme), numrin e shkollave të larta e të fakulteteve, numrin e nxënësve e të studentëve, numrin e banorëve në Kosovë etj.

Libri ka parathënien e fusnotat. Fusnotat janë dhënë në fund të se cilës kaptinë dhe kanë edhe funksionin e literaturës së përdorur gjatë hartimit të këtij libri.

*Prishtinë, tetor 2008 T. Foniqi*

## TIPAT E BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË

### Formimi i rrjetit

Rrjeti i bibliotekave në Kosovë është formuar gjatë periudhës 1944-1986. Këtij rrjeti i kanë paraprirë bibliotekat e ashtuquajtura sindikale, të cilat janë themeluar në organizatat e ndryshme punuese në qytetet e vendbanimet: Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Zveçan, Kuçishtë e Tërstenik të Pejës etj. Këto biblioteka, më vonë, kanë qenë nisma të formimit të bibliotekave speciale. Pasonjë, tevona, bibliotekat publike, shkollore etj.

Lidhur me bibliotekat sindikale flet edhe kjo e dhënë: “Punëtorët e sharrave me avull në Pejë kanë formuar biblioteka dhe salla leximi. Biblioteka deri tash numron më se 150 libra shqip, serbisht e rusisht. Është në zhvillim e sipër fushata për gjetjen e librave të reja. Punëtorët në mbledhjen e vet kësaj biblioteke ia ngjiten emrin “Proleter”. Është pajtuar në 10 fletore të

përditshme dhe të përjavshme dhe merr revista mujore. Biblioteka të shumtën e kohës është e mbushur me punëtorë, sepse këta gati të gjithë kohën e lirë e kalojnë në të”. Biblioteka të këtilla ka pasur edhe në “Postelegrafën” e Gjakovës, formuar më 1947, me ç’rast punëtorët dhurojnë 40 libra, Punëtorinë e pyjeve në Kuçishtë të Pejës, me emrin “Përparimi”, në Zveçan, Tërstenik të Pejës etj. Biblioteka në Zveçan, më 1952, ka pasur 4000 libra.

Në mbarim të dhjetëvjetëshit 1944-1954 kanë qenë 294 biblioteka: 146 publike, 24 speciale e 124 shkollore: 104 të shkollave fillore e 21 të shkollave të mesme. Rrjetin më të zhvilluar të bibliotekave e kanë pasur: rajoni i Nerodimjes 33: 14 publike e 19 shkollore, Sharrit 28: 12 publike e 16 shkollore, Istogut 27: 1 popullore e nga 13 shkollore e speciale, Gjilanit 25: 23 publike e 2 shkollore, Pejës 21: 16 publike e 5 shkollore, Vushtrrisë 20: 14 publike e 6 shkollore, Llapit 19: 1 publike, 10 speciale e 8 shkollore, Gjakovës 17: 10 publike e 7 shkollore, Zveçanit 17: 13 publike e 4 shkollore, Gorës 16: 10 publike e 6 shkollore, Podrimjes 15: 13 publike e 2 shkollore, Sitnicës 15: nga 1 publike e speciale e 13 shkollore, Suharekës 11: 8 publike e 3 shkollore, Prishtinës 9: 1 publike e 8 shkollore, Drenicës: 5 publike, Anamoravës 5: 1 publike e 4 shkollore, Graçanicës: 3 publike(1).

Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës

Burimet rreth themelimit të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës janë kundërthënëse. Përmenden katër vite të themelimit: 1944, 1945, 1946 e 1962. Citoj: “Institucioni i parë bibliotekar qendror dhe amë për territorin e Kosovës u themelua në Prizren në dhjetor të vitit 1944”, ndërsa në një botim enciklopedik thuhet: “Në Prizren më 1945 u formua Biblioteka Krahinore e cila prej v. 1946 e merrte nga një ekzemplar të obligueshëm prej RP të Serbisë”. Apo “Në vitin 1961 u hap përsëri Biblioteka Krahinore e cila ishte formuar më 1946 në Prizren, por kur kaloi në Prishtinë për një kohë u shua puna e saj”, ka shkruar Dr. Fehmi Pushkolli. Në një burim tjetër është thënë: “Biblioteka Krahinore e Prishtinës u ngrit më 1962 me më pak se 10000 libra (2).

Këto pohime nuk konfirmohen me burime arkivore. Unë kam hulumtuar disa arkiva e kam takuar edhe personalitete të jetës politiko-shoqërore e kulturore të kohës, me qëllim që të ndriçohet kjo datë, si Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Nexhip Hebiçaj etj. Fadil Hoxha është përgjegjur kësaj: “Ne i bijshim disa vendime atëherë, atje, në Bunjaj. Ndoshta e kemi prurë edhe vendimin për formimin e Bibliotekës Krahinore. Por çka bahej me ato vendime ma vonë, as vetë nuk e di mirë”, kurse Xhavit Nimani thotë: “Kjo Bibliotekë është formuar më 1945 duke u mbështetur në disa rrethana të atëhershme shoqërore-politike”.

Biblioteka Krahinore, për herë të parë, përmendet në

një material buxhetor më 1947, ku thuhet: “Furnizimi i Bibliotekës Krahinore me libra, ndriçimi, pajisja, material zyrash, ndihmë bibliotekave të fshatrave e të rretheve...” (3). Prandaj mendimi im është ky: këtu bëhet fjalë për të njëjtin institucion bibliotekar, por në funksion të trefishtë: Bibliotekën komunale të Prizrenit, Bibliotekën rajonale e Bibliotekën Krahinore.

Rruga e zhvillimit dhe e konsolidimit institucional të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës, prej themelimit deri në mbarim të periudhës sonë në shqyrtim, 1944-1986, ndahet në dy periudha kryesore: A. Biblioteka Krahinore 1944-1952, B. Biblioteka Popullore Krahinore, përkatësisht Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës 1961-1986.

#### Biblioteka Krahinore 1944-1952

Më 1946 Biblioteka Krahinore, bashkë me të gjitha institucionet, transferohet në Prishtinë dhe vendoset në lokalet e bibliotekës publike të këtij qyteti. “Në fillim të vitit 1948 këto dy biblioteka, së bashku, kanë pasur rreth 8000 libra” (4).

Më 1952 mbyllet Biblioteka Krahinore dhe fondet e saj: 11500 njësi bibliotekare, libra e periodikë, bëhen pronë e Bibliotekës publike të Prishtinës. Katër vjet më vonë, më 31.V.1956, formohet Qendra e Bibliotekave e KAKM-së e cila ka vepruar deri më 1961. Gjatë kësaj periudhe, ky institucion, ka kryer disa punë me rëndësi bibliotekare: ka bërë propagandimin e librit e të bib-

liotekave, është kujdesur për zhvillimin e rrjetit të bibliotekave në Kosovë, ka organizuar rryme (trajtime) e seminare bibliotekare, ka organizuar e rregulluar disa biblioteka në terren, ka propozuar masat për ngritjen profesionale të kuadrove bibliotekare etj.

Qendra e Bibliotekave e KAKM-së ka pasur cilësinë e institucionit të pavarur bibliotekar, e cila e kishte edhe Pleqësinë dhe Këshillin Shkencor. Këshilli Shkencor është formuar më 1960. Këtë Këshill e përbënin drejtorët e pesë bibliotekave publike të Kosovës dhe punonjësit e Qendrës së Bibliotekave të KAKM-së.

Biblioteka Krahinore rithemelohet më 21 nëntor 1961 me Vendimin e Këshillit Popullor Krahinor numër 4306 (5) me emërtimin Biblioteka Popullore Krahinore, ku hyn edhe Qendra e Bibliotekave të KAKM-së. Ajo rithemelohet, në kohën, kur ia fillojnë punës edhe Grupet e para të Fakultetit Filozofik të Prishtinës: Grupi i Matematikës, Grupi i Fizikës, Grupi i Kimisë, Grupi i Biologjisë, Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë Serbokroatishte dhe Grupi i Gjuhës dhe i Letërsisë shqipe.

Biblioteka ia ka filluar punës në janar 1962 në ndërtesën numër 36 në rrugën “Ramiz Sadiku” në një lokal me dy dhoma me 104 metra katrorë sipërfaqe. Punëtorët e parë të Bibliotekës Popullore Krahinore kanë qenë: Milan Jankoviqi, Idriz Mehmeti, Sveta Mihajloviqi, Radovan Kompiroviqi, Radojka Vulcanoviqi, Sinan Tatari etj.

Në fillim Biblioteka kishte rreth 1465 libra, 50 vjetarë periodikë dhe materialin për 50 biblioteka lëvizëse, të

tubuara përmes dhuratave, të koleksioneve të bibliotekës publike të Prishtinës, Institutit Albanologjik të Prishtinës etj. Në mbarim të vitit 1962 Biblioteka kishte katër njësi organizative: Sekretariati me referatet: referati për çështjet personale dhe organizative, i kontabilitetit, daktilobyrosë dhe referati për punët teknike e ndihmëse, Seksioni për përpunimin e librit me referatet: referati për pranimin e librit, periodikut dhe të materialit tjetër bibliotekar, referati për formimin e skedarëve dhe referati për hartimin e bibliografive, Seksioni për përparimin e bibliotekarisë me referatet: të analizës dhe Seksioni për punët me lexues me referatet: të depos dhe të sallave. Gjatë kësaj periudhe Biblioteka angazhohet sidomos rreth pasurimit të koleksioneve të librit, kryesisht përmes blerjes, organizimit e brendshëm të Bibliotekës, shkollimin dhe aftësimin profesional të kuadrove bibliotekare, përparimin e veprimtarisë së bibliotekave në terren, përmirësimin e gjenjdisë së lokalit bibliotekar etj. Po ashtu Biblioteka angazhohet edhe për sigurimin e ekzemplarit të obligueshëm të gjërave të shtypura në Jugosllavi me qëllim të kompletimit të koleksioneve bibliotekare karshi kërkesave të shtuara të lexuesve, sidomos nga radhët e studentëve. Që nga gushti 1963 kjo Bibliotekë fillon ta rimarrë ekzemplarët e obliguar të gjërave të shtypura të botimeve të Serbisë, ndërsa nga muaji prill 1965 e merr edhe ekzemplarët e obligueshëm të gjërave të shtypura të Jugosllavisë. Gjatë kësaj kohe biblioteka pasurohet edhe përmes dhuratave. Vetëm gjatë muajve maj-qershor 1962 në bibliotekë kanë hyrë 2969 libra

përmes dhuratave. Në mbarin 1964 ky numër arrin në 8038 kopje, të cilat i dhurojnë Biblioteka e Fakultetit Juridik të Novi Sadit, Biblioteka Popullore e Karlllocit, Biblioteka Popullore e Serbisë etj.

Më 1964 kjo bibliotekë e ndërron prapë lokalin dhe vendoset, po ashtu, në rrugën “Ramiz Sadiku”, ku ka qëndruar deri më 1982, kur ka dalë në objektin e ri, ku gjendet edhe tash. Më 15 mars 1965 ajo e jep në përdorim edhe sallën e leximit për studentë me 65 ulëse, bashkë me dy skedarë: të autorit dhe lëndor (Klasifikimi Universal Decimal). Këtë vit ky institucion shpallet Bibliotekë qendrore për territorin e Kosovës.

Në gjysmën e dytë të vitit 1965 Biblioteka Popullore Krahinore ka pasur rreth 47000 kopje libri, të cilat janë shtuar mesatarisht nga 1000 kopje në muaj. Mirëpo numri i librave, me mundësi qasjeje, ka qenë i vogël e sillej 15000-16000 kopje. Ndërkaq numri i njërive periodike, të hyra në Bibliotekë gjatë viteve 1962-1966, sillej rreth 3300 në vit. Më 1966 Biblioteka bëhet dykatëshe me ç’rast e intensifikon veprimtarinë e saj bibliotekare. Kah gjysma e vitit 1966 ajo kishte mbi 50000 kopje të librit, kur fillon ta marrë nga një ekzemplarë falas të periodikut të Jugosllavisë. Që nga viti 1967 biblioteka e fillon këmbimin me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë. Vetëm gjatë vitit 1967 biblioteka jonë ka marrë, nga Shqipëria, 120 tituj librash e 35 kopje të periodikut. Gjatë viteve 1968-1969 në Bibliotekë formohen edhe tri seksione: Seksioni i Bibliografisë, Seksioni Për pasurimin e

Fondeve dhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Shumëzimin e Materialit Bibliotekar.

B. Biblioteka Popullore Krahinore, përkatësisht Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës 1961-1986

Më 1970 Kuvendi Krahinor i KSA të Kosovës nxjerr Ligjin për themelimin e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës me qëllim që “të përhapë arsimin dhe kulturën e përgjithshme dhe të ndihmojë në punën shkencore profesionale si dhe t’i plotësojë nevojat kulturore në sferat e tjera të jetës” (6).

Nga ky vit biblioteka vëhet në funksion të dyfishtë: Bibliotekë e përgjithshme kombëtare dhe Bibliotekë Universitare, kur edhe intensifikohet pasurimi i koleksioneve të bibliotekës, përpunimi profesional i koleksioneve, rrumbullaksimi i organizimit të brendshëm të Bibliotekës etj. Më 1973 biblioteka kishte 202271 njësi bibliotekare të përpunuara: libra e periodikë. Vetëm gjatë vitit 1976 biblioteka i pasuron fondet e veta edhe me 23490 njësi të librit: 19274 përmes ekzemplarit të detyrueshëm, 3579 përmes blerjes, 502 përmes këmbimit e 135 përmes dhuratave. Në anën tjetër Seksioni i periodikut përpunon 650 tituj të rinj apo 5770 blenj, përkatësisht 31755 fletushka. Prej këtyre 65 tituj kanë qenë në gjuhë të huaja. Gjatë viteve 1973-1978 biblioteka anëtarëson 18000 anëtarë të rinj, të cilët janë shërbyer me 400000 njësi bibliotekare: libra e periodikë.

Gjatë periudhës 1973-1984 në bibliotekë pavarësohen

edhe katër seksione profesionale: Seksioni për Përpunimin e Periodikut, Seksioni i Skedarit të Autorit, Qendra Referale dhe Seksioni i Fondeve të Veçanta.

Më 25 nëntor 1982 përurohet objekti i ri, modern, i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës me 16500 metra katrorë sipërfaqe (ndërtimi ka filluar më 1975 e ka përfunduar më 1981). Me këtë rast është thënë se Biblioteka ka rreth 700000 vëllime bibliotekare. Nisur nga viti 1983, në bibliotekë, organizohen edhe provimet profesionale nga lëmi i bibliotekarisë. Thirrjet e para profesionale bibliotekare, të organizuara këtu, i kanë marrë kandidatët: Sllavisha Momçilloviqi, Jorgovanka Popoviqi, Shqipe Zhubi, Ymri Vesiqi (librar), Lavdërie Domi, Stana Trajkoviqi (librar i lartë) dhe Jusuf Gashi e Sheherzade Shkreli (bibliotekar).

Në mbarim të vitit 1986, BPU e Kosovës ka pasur 563828 njësi bibliotekare të botimeve monografike e 9784 tituj të botimeve periodike: 6888 të revistave e 2896 të gazetave. Vetëm në Fondet e Veçanta kanë qenë rreth 600 njësi libri në gjuhët orientale. Vlerë të vaçantë këtu paraqesin 150 dorëshkrime në gjuhën arabe, turko-osmane e persishte dhe dorëshkrimet shqipe me alfabetin arab. Biblioteka ruan edhe dorëshkrime të Zef Serembes, Anton Santorit etj. Nga Anton Santori ruan dorëshkrimin e dramës “Emira” e vitit 1864, dhuratë e shkrimtarit Ramiz Kelmendi dhe dorëshkrimin “Kalucio e Serafina”, dhuratë e Gjuzepe Ferrarit. Biblioteka ruan, po ashtu, edhe dorëshkrimin “Skica e bibliografisë mbi Skënderbeun” e vitit 1968. Këto materiale bibliotekare janë siguruar përmes kop-

jes së detyruar, blerjes, këmbimit e dhuratave. Sipas librave të inventarit të bibliotekës, gjatë periudhës 1944-1986, në bibliotekë përmes dhuratave, kanë hyrë 40986 njësi bibliotekare, shumica në gjuhën shqipe. Këto njësi i kanë dhuruar institucionet dhe individët. Më se shumti libra kanë dhuruar: Mehmet Gjevori 1780, Shaqir Kastrataj 1638, Stathi Kostari 408, Talat e Shani Pallaska më se 350 (arkivi familjar libra e dokumente kryesisht në gjuhët orientale), Mark Krasniqi 314, Ali Jasiqi 203, Abdulla Zajmi 158, Fehim Rexhepi 132, Fadil Hoxha 90, Vllaznim Xhiha 25, Aleksandër Zoto 10, Murat Morina 9 libra në gjuhët orientale), Muhamed Mufaku (raritete e kopje të dorëshkrimeve), Esad Stavileci, Ramiz Kelmendi, Liman Rushiti, Radomir Ivanoviqi, Vlladeta Vukoviqi, Ratko Deletiqi, Murteza Shllaku, Ruzhdi Ushaku, Lush Gjergji, Ali Podrimja, Nol Berisha, Simë Dobreci, Qazim R. Lleshi, Rrahman Dedaj, Ejup Statovci, Francesko Solano (Dushko Vetmo), Karmell Kandreva, Baki Ymeri, Thoma Kacorri, Shkëlzen Maliqi, Ramush Rama, Zenun Çelaj, Olga Mishevska Tomiqi, Rifat Musa, Ferat Rexhepi, Arben Hetemi, Ali Cungu, Xhafer Morina, Marko Radelica, Rexhep Qosja, Anton Pashku, Shkëlzen Raça, Rexhep Ismajli, Vinçenc Malaj, Osman Gashi, Esad Kamberi, Omer Voshtina, Zef Mirdita, Gjyltekin Shehu, Ilaz Kroma, Nexhip Allpani, Antonio Athanasi, Gjuzefina Kuçia Lojakono, Abdylatif Arnauti, Gjuzepe Ferrari, Antonio Belushi, Gjuzepe Skiro di Maxho, Freja Maloki, Gjerg Danieli, Demush Shala, Azem Shkreli, Tibor Sekel, Ismet

Spahiu, Fadil Azemi, Fais Ferati, Nexhat Ruhani, Hajdar Domi etj.

Gjatë periudhës 1962-1986 Biblioteka ka blerë disa fonde me interes të literaturës shkencore nga individët dhe institucionet e ndryshme. Gjithsej janë blerë 86378 njësi bibliotekare. Nga individët janë blerë: prej Hasan Kaleshit 1625 njësi në gjuhën: shqipe, serbokroatishte, turqishte, arabishte, frëngjishte, anglishte, gjermanishte, rusishte, bullgarishte, italishte, greqishte, hungarishte, çekishte, maqedonishte etj., Nikola Belocerkovcit 1522, Drag. Ikoviqit 329, Sadulla Brestovcit 128 etj. Më se shumti njësi bibliotekare janë blerë më 1978-9500.

Me këmbim, gjatë viteve 1973-1977, 1980 e 1984-1986, biblioteka i ka pasuruar fondet e veta me 4150 njësi. Këmbimi është zhvilluar me Shqipërinë, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Bibliotekën e Kongresit Amerikan, Bibliotekën Shtetërore të Rumanisë, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë etj. Pra, gjatë viteve 1962-1986, përmes blerjes, dhuratave e këmbimit, në Bibliotekë kanë hyrë mbi 134932 njësi bibliotekare (7).

#### Bibliotekat publike

Përpara Luftës së Dytë Botërore nuk mund të flitet për farë rrjeti të bibliotekave publike në Kosovë. “Në territorin e Kosovë-Metohis ka pasë para lufte vetëm tri biblioteka popullore publike me një fond që nuk i kalonte gjashtëmijë libra” (8).

Biblioteka e parë publike në Kosovë është formuar në Prizren më 25 dhjetor 1944 me emrin Biblioteka Popullore “Bratstvo”. Punëtorët e parë të kësaj biblioteke kanë qenë Krunoslav Lekovci, Aleksandar Gazikaloviqi, Vjekoslav Gjorgjeviqi, Dobrilla Shutakoviqi etj. Ndërkohë këtu punësohen edhe kuadrot e para shqiptare, Lili Berisha (punëtorja e parë shqiptare, Myjezen Hoxha (themeluese e Sektorit të fëmijëve) etj.

Fondi fillestar i kësaj biblioteke, rreth 2450 vëllime, është formuar prej dhuratave të qytetarëve të Prizrenit, bibliotekës së shkollës për mësues “Bogoslovija” të Prizrenit, Gjimnazit të Prizrenit, bibliotekës së oficerëve të qytetit të Prizrenit etj. Në mbarim të vitit 1944 biblioteka kishte 3000 libra.

Fillimisht puna në këtë bibliotekë është zhvilluar në baza vullnetare. Në mars 1946 biblioteka e siguron punëtorin e parë të përhershëm me pagesë. Mirëmbajtja e Bibliotekës është bërë nga pagesa e anëtarësisë, të ardhurat nga organizimi i jetës kulturore-argëtuese të bibliotekës, ndihmat e shtetit etj. Gjatë viteve 1947-1952 fondi i librave të bibliotekës së Prizrenit shtohet nga 3227 në 6966 kopje (9).

Në shkurt 1945 hapet biblioteka tjetër publike në Kosovë. Në burim thuhet: “Në mënyrë solemne, në praninë e një numri të madh njerëzish, u hap biblioteka e parë popullore në Prishtinë. Biblioteka qysh sod disponon, përveç të gjitha fletushkavet dhe broshuravet Nacional-Çlirimtare me ma se 1300 libra në gjuhën serbishte e shqipe” (10). Bibliotekën e ka çelur Ismet

Shaqiri, kurse fjalën e rastit e ka mbajtur Leposava Protiqi.

Më 1986 biblioteka publike e Prishtinës kishte shtatë sektorë: 1. Sektori i hulumtimit dhe zhvillimit bibliotekar, 2. Sektori i pasurimit dhe përpunimit të koleksioneve, 3. Sektori i të rriturve, 4. Sektori i fëmijëve, 5. Sektori i periodikut, 6. Sektori i trashëgimisë dhe ruajtjes së librit, 7. Sektori i financave, administratës dhe i punëve të përbashkëta.

Më 1945 biblioteka publike formohen edhe në Gjilan, Kaçanik, Mitrovicë e Podujevë. Në mbarim të dhjetëvjetëshit 1944-1954 dihet për 15 biblioteka publike në Kosovë: Prizren, Prishtinë, Gjilan, Kaçanik, Mitrovicë, Podujevë, Vushtrri, Lipjan, Gjakovë, Pejë, Viti, Ferizaj, Glllogoc, Dragash e Deçan. Në mbarim të kësaj periudhe numri i këtyre bibliotekave arrin në 167. Një bibliotekë binte në 8.31 vendbanime, përkatësisht 4886 banorë. Më 1955 numri i bibliotekave shtohet për 39, që shihet edhe nga ky burim, ku thuhet: “Në Krahinën tonë punojnë tash 19 biblioteka qendrash komunale dhe 187 biblioteka e salla leximi katundesh, pa marrë parasysh numrin e madh të themelatave kësodore që egzistojnë nëpër shkollat e sipërmarrjet e ndryshme” (11).

Rrjetin më të zhvilluar të bibliotekave publike e kanë pasur rajoni i Gjilanit, Pejës, Nerodimjes, Podrimjes, Vushtrrisë, Sharrit, Zveçanit, Gorës, Suharekës, Graçanicës etj., ndërse rrjet të dobët kishin rajoni i Anamoravës, Istogut, Llapit, Sitnicës etj.

Gjatë dhjetëvjetëshit 1944-1954 biblioteka publike formohen edhe në disa fshatra: në Lluzhan e Shajkovc

të komunës së Podujevës, Grackë të Lipjanit, Shkorobisht të Suharekës etj. Biblioteka në Shkorobisht, me rastin e formimit më 1946, kishte 80 libra në gjuhën shqipe e serbokroatishte. Për këtë bibliotekë gjendet edhe ky citat; “Dhoma e bibliotekës asht e pastërt, ka dy tavolina të vogla, një tavolinë të gjatë dhe 6 banka të gjata. Vullnetarisht janë paraqitur 3 persona të cilët kanë me veprue si udhëheqësa të grupeve punuese” (12).

Gjatë dhjetëvjetëshit 1944-1954 janë dalluar edhe biblioteka e Pejës, Prishtinës, Vushtrrisë, Gjakovës, Mitrovicës etj. Më 1948 biblioteka e Pejës kishte 1600 kopje librash në gjuhën shqipe e serbokroatishte. Kishte edhe sallën e leximit e merrte edhe disa gazeta e revista. Më 1952 këtu numri i librave arrin në 3173: 2750 serbokroatisht, 400 shqip e 23 në gjuhë të tjera. Ndërkaq biblioteka e Prishtinës, më 1949, ka pasur 1600 anëtarë të regjistruar, sallën e leximit, ndërsa merrte edhe shtypin e ditës. Këtë vit, kjo bibliotekë, organizon një ekspozitë të librit, e cila zgjat tri ditë. Një ekspozitë e organizon edhe më 1952. Ndërkaq më 1952 biblioteka e Vushtrisë pasurohet me 393 libra. Ajo kishte 211 lexues, të cilët kanë lexuar 1700 libra gjatë këtij viti. Për çdo dy javë këtu organizohet orë letrare. Këtë vit këtu organizohet edhe një ekspozitë e librit. Në anën tjetër biblioteka e Gjakovës, më 1954, ka pasur 3000 libra. Kishte, në përdorim, edhe skedarin e autorit sipas alfabetit dhe kartotekën e lexuesve. Kishte, po ashtu, edhe sallën e leximit e merrte edhe disa tituj periodiku shqip e serbokroatisht. Çdo

ditë këtu freguentonin 150 nxënës. Apo biblioteka e Mitrovicës, rreth 1952, prej numrit të përgjithshëm të banorëve të Mitrovicës, 5.5 për qind e tyre kanë qenë anëtarë të bibliotekës, prej tyre gjysma ishin nxënës, 20 për qind nëpunës, 20 për qind pensionistë e shtëpiake e 10 për qind punëtorë.

Formimi i bibliotekave publike e leximoreve, sidomos në fshatra, ka pasur rëndësi të madhe, sepse ato, atje, shërbenin edhe si vatra për plotësimin dhe edukimin e arsimimit shkollor, përhapjen e kulturës së përgjithshme, edukimin profesional etj.

Në mbarim të vitit 1953 bibliotekat publike kanë pasur 129847 libra e 25417 lexues: rajoni i Gjilanit 3116 libra e 417 lexues, Anamoravës 2636 libra e 400 lexues, Gorës 5375 libra e 104 lexues, Gjakovës 10770 libra e 1959 lexues, Zveçanit 13573 libra e 1981 lexues, Istogut 4083 libra e 159 lexues, Kamenicës 6740 libra e 596 lexues, Llapit 9489 libra e 454 lexues, Sitnicës 1863 libra e 97 lexues, Pejës 19642 libra e 2283 lexues, Podrimjes 9002 libra e 2100 lexues, Suharekës 6382 libra e 700 lexues, Sharrit 7176 libra e 1501 lexues dhe Prishtinës 30000 libra e 12666 lexues. Disa rajone kanë pasur numër të mirë të librave, por numri i lexuesve ishte i vogël, si në rajonin e Sitnicës, Gorës, Istogut etj.

Gjatë dhjetëvjetëshit 1944-1954 gjendja e bibliotekave publike, në disa vendbanime, ka qenë e varfër, madje edhe në rajonin e Prishtinës. Stathi Kostari, pasi kishte vizituar fshatrat Bellaqevc i Madh, Kuzmin e Grabovc, që të hetonte gjendjen e këtyre bibliotekave, deklaroi:

“Libra ka në ndonjë dollap, po leximorja nuk punon për shkak të lokalit”. Ndërkaq për bibliotekat në fshatin Llapllasellë e Koliq, thuhet: “Në Llapllesellë nuk ka leximore. Në Koliq, ku punon leximorja... krejt çka ka është vendosur nëpër shkolla dhe banesa a zyra” (13). Gjendja ka qenë e këtillë edhe në fshatrat Devet Jugoviq, Bakshi, Raskovë, Bërnice e Poshtme, Obiliq etj.

Risi e dhjetëvjetëshit 1944-1954, ndërkaq, paraqet fillimi i rregullimit profesional të koleksioneve të bibliotekave, fillimi i formimit të paraleleve apo sektorëve për fëmijë, organizimi i fondeve apo bibliotekave lëvizëse etj.

Gjatë dhjetëvjetëshit 1955-1965 rrjeti i bibliotekave publike pasurohet edhe me shtatë biblioteka të reja: Kamenicë, Leposaviq, Skënderaj, Rahovec, Suharekë, Istog e Klinë. Më 1956 flitet për 158 biblioteka publike me më se 248586 libra. Në këtë dhjetëvjetësh janë dalluar biblioteka e Suharekës, Deçanit, Ferizajt, Kaçanikut, Lipjanit, Lluzhanit, Gjakovës, Gjilanit, Pejës etj. Rreth vitit 1962 biblioteka e Suharekës kishte literaturë të pasur në gjuhën shqipe, gjithsej 2355 libra, ndërsa biblioteka e Deçanit, rreth 1960, ka pasur afër 5000 libra dhe ishte njëra ndër bibliotekat publike më të mira në Kosovë, kur edhe shpërblehet nga Pleqësia për Kulturë e Serbisë me 1200 libra. Njëherit ajo kishte 600 anëtarë të regjistruar, kryesisht nxënës e bujq. Kah mesi i vitit 1962 kjo bibliotekë kishte fondin e librave prej 5120 në gjuhën serbokroatishte e 1460 në gjuhën shqipe. Disa prej lexuesve të saj, gjatë vitit, lexonin deri

50 libra. Më 1964 biblioteka e Deçanit blen të gjitha botimet e Rilindjes, “Nolit” it të Beogradit e “Zora” të Zagrebit, kurse kishte lexues edhe nga radha e bujqve. Në këtë periudhë është dalluar edhe biblioteka e Ferizajt. Ajo kishte rreth 7000 libra e salla të leximit edhe në degët e veta: Shtime, Nerodime, Gatnje e Talinocv. Ndërkaq biblioteka e Kaçanikut mbante kartelën e lexuesve dhe fondet e librit i kishte të rregulluara sipas parimeve të KUD-it (Klasifikmi Universal Decimal). Më 1965 edhe biblioteka e Lipjanit dhe ajo e Lluzhanit bëhen me salla të leximit. Janë dalluar edhe biblioteka “Progres” e Gjakovës, “Njegosh” e Pejës etj. Rreth vitit 1957 biblioteka e Gjakovës, pos librave, ka marrë edhe 25 gazeta e revista. Këtu më se shumti janë lexuar Daviço, Stendali, Balzaku, Tolstoi, J. J. Zmaji, Qopiqi, Anton Çetta, Xhek Londoni etj. Ndërkaq biblioteka e Pejës, më 1960, ka pasur 9760 libra, 70 për qind beletristikë. Në fillim të vitit 1961 numri i librave këtu arrin në 11500, ndërsa numri i lexuesve të rregullt rritet në 2230. Këtu më se shumti janë lexuar Cvajgu, Alberto Moravija, Daviço, Esad Mekuli, përkatësisht periodiku “Jeta re”, “Izraz”, “Delo” etj.

Kah gjysma e vitit 1962 në Kosovë numërohen 110 biblioteka publike e salla të leximit me 283152 libra, 75360 në gjuhën shqipe. Më 1963 numri i librave, të këtyre bibliotekave, arrin në 301 mijë: 208 mijë në gjuhën serbokroatishte e 82 mijë në gjuhën shqipe.

Që nga fillimi i dhjetëvjetëshit 1955-1965 fillon të bjerë numri i bibliotekave publike, si rrjedhojë e riorganizimit (fuzionimit) të komunave, që zgjat deri më 1961, por

kjo reflekton edhe anë pozitive. “Sepse aq sa ka rënë numri i bibliotekave për kah kuantiteti, për aq veprimtaria e tyre ka shënuar rritje kualitative” (14). Kështu, më 1956, në Kosovë, kanë qenë 158 biblioteka publike, 1957-128, 1958-102, 1959-82, 1961-71, ndërsa, në anën tjetër, rritet numri i librave në bibliotekat ekzistuese. Më 1955 bibliotekat publike kanë pasur 195000 libra, 1956-238000, 1957-259000, 1958-252000, 1959-233000, 1960-269000, 1961-288000. Gjatë kësaj periudhe, në 100 banorë, binte ky numër librash në komuna: Suharekë 53, Gjilan 51, Prishtinë 50, Mitrovicë 48, Zym 44, Prizren 35, Pejë 30, Kamenicë 26, Vushtrri 25, Viti, Dragash e Gjakovë 22, Istog e Leposaviq 21, Malishevë 19, Lipjan 17, Skënderaj e Shtërpçë 16, Zubin Potok, Novobërdë e Podujevë 14, Klinë 12, Rahovec e Ferizaj 11, Glllogoc 9, Orllan 5 e Kaçanik 4.

Rreth vitit 1960, 60 për qind e fondit të librave të bibliotekave iu takonin tetë bibliotekave të komunave më të mëdha, ndërsa 40 për qind tetëmbëdhjetë komunave më të vogla.

Numri i bibliotekave rritet edhe gjatë periudhës 1966-1976. Tash biblioteka hapen edhe në vendbanimet: Sllatinë, Muçivërcë, Devet Jugoviq, Komoran, Janjevë, Batllavë, Banjë e Pejës, Brodosanë, Qirez, Bare, Bellaqevc, Magurë, Tugjevç etj. Ndër këto, më e dalluara, ka qenë biblioteka e Muçivërcës, e cila, më 1964, kishte rreth 2500 libra, lokalën e përshtatshëm për bibliotekë dhe punëtorin e përhershëm për punët bibliotekare. Më 1964, në këtë bibliotekë, janë lexuar

600 libra, kryesisht nga radha e nxënësve. Librat më të lexuara këtu kanë qenë: “Kasollja e xha Tomit” e Harieta Biçer-Stou, romani “Karvani i bardhë” i Azem Shkrelit, “Lugjet e verdha” e Rexhep Hoxhës, “Libri mbi Titon” i France Bevkut etj.

Janë dalluar, ndërkohë, edhe biblioteka e Prilluzhës e cila, më 1968, kishte mbi 3000 libra e, gjatë ditës, jepeshin në lexim rreth 30, ajo e Vushtrrisë, Ferizajt, Lipjanit, Gjilanit, Prishtinës, Skënderajt etj. Më 1967 biblioteka e Vushtrrisë ka pasur 9400 libra, 2500 në gjuhën shqipe. Ndërsa numri i lexuese arrin në 900: nxënës, arsimtarë, nëpunës etj. Gjatë muajve janargusht 1967 këtu janë lexuar 7300 libra. Kjo bibliotekë merrte edhe 17 tituj të botimeve periodike. Ndërkaq, biblioteka në Ferizaj, më 1966, e trefishon numrin e librave në krahasim më 1965.

Rreth vitit 1966 librat më të kërkuara kanë qenë romanet “Lulja e kujtimit” e Foqion Postollit, “Sikur t’isha djalë” i Haki Stërmillit, “Gjaku i papastër” i Borisav Stankoviqit, librat e bujqësisë “Blegëtorja”, “Përdorimi i plehnave kimikë” etj. Pra, bibliotekat kishin lexues edhe nga radha e bujqve.

Më 1976 Kosova kishte 184 biblioteka: 22 të përqëndruara në qendrat komunale me 162 degë. Krahasuar më 1961 numri i këtyre bibliotekave është shtuar për 71 ose 39 për qind. Prej këtyre 25 biblioteka kanë punuar në qendrat komunale, 126 në fshatra e 11 në organizatat punuese: 1 në komunën e Kamenicës e nga 5 në komunën e Prishtinës e Mitrovicës. Kanë funksionuar edhe 17 biblioteka apo fonde lëvizëse: nga 5 në

komunën e Mitrovicës e të Pejës e 7 në komunën e Prishtinës. Një bibliotekë publike ka rënë në 7.8 vendbanime, përkatësisht 8403 banorë. Nga tri degë të bibliotekave i kanë pasur komuna e Glllogocit, Rahovecit, Pejës dhe e Vushtrrisë, nga 4 ajo e Dragashit, Kaçanikut, Leposaviqit dhe e Vitisë, nga 5 e Deçanit, Istogut, Klinës dhe e Lipjanit, nga 6 e Suharekës dhe e Ferizajit, nga 7 e Podujevës dhe e Skënderajt, 8 e Kamenicës, 10 e Gjakovës, 12 e Gjilanit, 16 e Mitrovicës dhe 42 e Prishtinës. Rrjet më të zhvilluar të bibliotekave ka pasur komuna e Prishtinës, ku një bibliotekë ka rënë në 2.2 vendbanime, ndërsa rrjetin më të varfër e kishte komuna e Leposaviqit. Atje një bibliotekë binte në 14 vendbanime. Gjatë kësaj periudhe e kemi veçuar Bibliotekën publike të Rahovecit e cila, më 1976, ka pasur 20450 libra, 6850 për fëmijë e 290 lexues nga radha e fëmijëve.

Këto biblioteka kanë pasur 913820 kopje libri, 221867 për fëmijë ose 22 për qind e 410 tituj të shtypit periodik. Për banor kanë rënë 0.8 libra.

Katër biblioteka komunale (bashkë me degët) kanë pasur deri 20000 kopje të librit: Deçani, Dragashi, Kaçaniku, Klina, gjashtë 20001-30000 : Glllogoci, Istogu, Leposaviqi, Lipjani, Rahoveci e Vitia, katra 30001-40000: Podujeva, Skënderaji, Suhareka e Ferizaj, dy 40001-50000: Peja e Vushtrria, tri 50001-60000: Gjakova, Kamenica e Prizreni, dy 80000-110000: Gjilani e Mitrovica dhe Prishtina kishte mbi 200000 libra. Gjashtë biblioteka kanë pasur deri 10 tituj të periodikut: Suhareka, Vushtrria, Vitia, Leposaviqi, Deçani e

Rahoveci, nëntë 11-20: Gjakova, Skënderaji, Istogu, Lipjani, Dragashi, Podujeva, Kaçaniku, Klina e Mitrovica, shtatë 21-67: Prishtina, Ferizaj, Kamenica, Glllogoci, Prizreni, Peja e Gjilani.

Gjatë vitit 1976 bibliotekat anëtarësojnë 77918 përdorues ose 6.3 për qind të mbarë popullsisë në Kosovë. Këtë vit janë lexuar 1503380 libra. Bibliotekat kanë pasur në shfrytëzim 252 lokale, 28 salla të leximit: 19 për të rritur e 9 për fëmijë. Salla për të rritur kishte në komunës e Prizrenit, Rahovecit e Skënderajt. Kurse salla për fëmijë ka pasur në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës, Lipjanit, Pejës, Podujevës, Prishtinës, Prizrenit e Ferizajit. Sallat e leximit, për të rritur e për fëmijë, kanë pasur 814 vende për lexim. Një karrige ka rënë në 96 lexues. Hapësirën e lokaleve bibliotekare e përbënin 5667 metra katrorë sipërfaqe (15).

Zgjerimi i rrjetit të bibliotekave ka vazhduar edhe më vonë. Vetëm gjatë viteve 1976-1980 “janë shtuar edhe 26 biblioteka në fshatra, janë pajisur me regale më se 60 biblioteka, është shtuar numri i vendeve për lexim edhe për 670 karriga, fondi librar është shtuar për 350780 libra” (16).

Më 1986 figurojnë 189 biblioteka publike, 5 më shumë se më 1976, ose 2.6 për qind. Një bibliotekë publike ka rënë në 7.6 vendbanime, përkatësisht 8383 banorë (regjistrimi 1981). Rrjetin më të pasur të bibliotekave e kishte biblioteka amë e Prishtinës, gjithsej 27. Ato kanë qenë të stacionuara në vendbanimet: Prishtinë, Hajvali, Graçanicë, Çagllavicë, Llapnasellë, Slivovë, Viti e Marevcit, Prekovic, Mramuer, Llabjan,

Llukar, Keqekollë, Koliq, Obiliq, Fushë-Kosovë, Hade, Bellaqevc, Sllatinë, Devet Jugoviq, Barilevë, Breznicë e Miloshevë.

Bibliotekat kanë pasur 1722509 kopje të librit, 808689 më shumë se më 1976 ose 46.9 për qind. Prej këtyre 448742 kanë qenë libra për fëmijë ose 26 për qind. Për kokë të banorit kanë 1.09 libra. Këtë vit, për herë të parë në Kosovë, arrihet proporcioni një libër për kokë të banorit. Biblioteka kishin edhe 426 tituj të perioidikut: 243 të revistave e 183 të gazetave, 16 më shumë se më 1976 ose 3.8 për qind.

Gjatë vitit 1986, në biblioteka, janë anëtarësuar 86310 lexues, 8392 më shumë se më 1976 ose 9.7 për qind. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë, këtë vit, 5.4 për qind kanë qenë anëtarë të këtij tipi të bibliotekave, pra, 4.6 për qind nën minimumin e standardeve bibliotekare të rajonit. Ata kanë lexuar 1213983 libra, 289397 më pak se më 1976 ose 23.8 për qind.

Bibliotekat kanë pasur në shfrytëzim 219 lokale bibliotekare, 21 salla të leximit: 12 për të rritur e 9 për fëmijë me 8862 metra katrorë. Salla të leximit, për të rritur, kanë pasur bibliotekat e komunës së Deçanit, Gjakovës, Gjilanit, Istogut, Kaçanikut, Leposaviqit, Lipjanit, Pejës, Prishtinës, Podujevës, Skënderajt e Vitisë, ndërsa salla të leximit, për fëmijë, kishin bibliotekat e komunës së Gjakovës, Gjilanit, Istogut, Kaçanikut, Pejës, Prishtinës, Podujevës, Skënderajt e të Vitisë (17).

Bibliotekat për fëmijë

Bibliotekat (paralelet, sektorët) për fëmijë kanë punuar brenda bibliotekave publike: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Pejë, Prishtinë etj. Ato janë formuar gjatë viteve 1956-1965: më 1956 në Prizren e Gjilan, 1957 në Gjakovë e Pejë e më 1965 në Prishtinë.

Fillimisht këto biblioteka kanë pasur 8615 libra: Prizreni 1300, Gjilani 800, Gjakova 1518, Peja 997 e Prishtina 4000.

Spektori i fëmijëve i Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit, më 1959, kishte 1334 libra për fëmijë. Ndërkaq më 1961 ai ka pasur 570 anëtarë të regjistruar, kryesisht nga radha e nxënësve të shkollave fillore të qytetit të Prizrenit. Gjatë këtij viti këtu janë lexuar sidomos librat: “Në krahët e fluturës” i Rexhep Hoxhës, “Libri mbi Titon” i Frence Bevkut, “Hajdi”, “Njizetmijë mila nën det” etj.

Më 1986 bibliotekat publike, në fondet e tyre për fëmijë, kanë pasur 332518 libra. Natyrisht këtu janë llogaritur edhe ilustracionet e lektyra shkollore për klasat e ulta të shkollave fillore.

Bibliotekat për fëmijë, pos veprimtarisë së tyre të rregullt bibliotekare, kanë zhvilluar edhe një varg aktiviteteve arsimore e kulturore për fëmijët, me qëllim të popullarizimit të librit e të bibliotekave.

\*

Për ilustrim e kemi veçuar këtu bibliotekën “Përrallat”, e cila është degë e bibliotekës publike të Prishtinës. Ajo

është formuar më 1965 në Qendrën e pionierëve në Ulpianë të Prishtinës. Me rastin e formimit kishte 4000 kopje libri, kryesisht ilustracione, ku ka ilustracione edhe për fëmijët parashkollorë. Dhjetë vjet më vonë (1975) numri i librave këtu arrin në 6000 e, më 1986, në 8000. Dyzet për qind e ilustracioneve janë pa tekst. Struktura gjuhësore e librave është 40 për qind në gjuhën shqipe e 60 për qind në gjuhën serbokroatishte. Biblioteka ka komplet lekturën shkollorë për klasat I-VIII të shkollës fillore e për klasat I-II të shkollave të mesme. Me fëmijët këtu punojnë tre punëtorë bibliotekarë me shkollë të mesme, dy me provim profesional të bibliotekarisë. Literatura është adekuate me moshën e fëmijëve. Në bibliotekë organizohen lloj-lloj aktivitete të arsimore e kulturore: bëhet dramatizimi i përrallave, reprodukohen, përmes vizatimeve, hero e personazhe nga librat e lexuara etj. Rreth vitit 1977 këtu ka punuar edhe Shkolla letrare, ku fëmijët kanë fituar njohuritë e para për artin e të shkruarit. Biblioteka ka në shfrytëzim 116 metra katrorë lokal bibliotekar. Këtu punohet, gjatë ditëve të punës, prej orës shtatë deri në orën nëntëmbëdhjetë.

Bibliotekat lëvizëse

Bibliotekat (fondet) lëvizëse kanë funksionuar në përbërje të bibliotekave publike gjatë periudhës 1952-1976: në Mitrovicë, Gjilan, Prishtinë, Vushtrri, Istog etj. Më 1952 biblioteka e Mitrovicës e vë në funksion një fond lëvizës të librave për territorin e komunës së

vet. Ndërkaq më 1957 biblioteka e Gjilanit organizon një fond lëvizës në degët e veta. Me këtë rast secila degë merr nga një valixhe me libra e numra të gazetave të përditshme. Materiali ka qenë i përpunuar sipas rregullave të këtyre fondeve. Për punët, me fonde, angazhoheshin personat, që kishin kryer kursin për evidentimin e dhënien e materialit në lexim.

Edhe Biblioteka Popullore Krahinore, më 1962, organizon 50 fonde lëvizëse, në arka specialë, për bibliotekat publike në terren.

Gjatë viteve 1962-1969 kanë funksionuar rreth 120 fonde lëvizëse: 11 në komunën e Gjilanit, 10 të Prishtinës, 5 të Vushtrrisë, 2 të Istogut, 2 në Shtëpinë e punëtorëve "Trepça" në Zveçan (dy valixhe të mëdha me libra kanë qëndruar nëpër repartet e punëtorëve). Në komunën e Prishtinës fondet kanë qëndruar në vendbanimet: Fushë-Kosovë, Obiliq, Devet Jugoviq, Miloshevë, Graçanicë etj., ndërsa në komunën Vushtrrisë ato kanë qëndruar në fshatrat: Novolan, Samadrexhë, Dubovc, Pantinë etj. Në këto fshatra fondet përbëheshin me nga rreth 150 kopje librash dhe ndërroheshin në çdo njëzet ditë.

Nisur nga 1964 këto fonde fillojnë të shuhet. Kështu "prej 75 bibliotekave lëvizëse në fund të vitit të kaluar (1964, nënv. im) kanë funksionuar vetëm 19" (18).

Më 1968 biblioteka komunale e Prishtinës e vë në përdorim edhe libërbusin, si lloj i avancuar i veprimtarisë së fondeve lëvizëse. Më 1976 kanë funksionuar vetëm 17 fonde lëvizëse: nga 5 në bibliotekat e komunës së Pejës e të Mitrovicës e 7 në komunën e Prishtinës.

Bibliotekat universitare

Bibliotekat universitare (të shkollave të larta e të fakulteteve) janë formuar gjatë periudhës 1958-1981 dhe lidhen me formimin e zhvillimin e shkollimit të lartë e superior në Kosovë.

Bibliotekat e shkollave të larta

Më 1958 formohet, në Prishtinë, biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike, pra, biblioteka e parë universitare në Kosovë. Në burim thuhet: “Me hapjen e Shkollës është hapur menjëherë edhe Biblioteka, si komponentë, hallkë, e domosdoshme për punë normale” (19).

Në fillim të punës kjo bibliotekë ka pasur 15000 libra, kështu që, për një student, kanë rënë mbi 100 libra. Më 1965 ky fond arrin në 20000 njësi bibliotekare.

Bibliotekat e tjera universitare janë formuar gjatë viteve 1962-1977: më 1962 formohet biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prizren dhe biblioteka e Shkollës së Lartë Ekonomike Komeriale në Pejë. Ndërkaq më 1968 është formuar biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” në Gjakovë. Më vonë formohen edhe dy biblioteka: më 1975 ajo e Shkollës së Lartë Pedagogjike “Skënderbeu” në Gjilan dhe, më 1977, biblioteka e Qendrës për Arsimin e Lartë në Ferizaj. Më 1986 kanë punuar gjashtë biblioteka të shkollave të larta: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan e Ferizaj.

Më 1986 këto biblioteka kanë pasur 102412 kopje librash: biblioteka e SHLP-së në Prishtinë 9508,

SHLP-së në Prizren 33502, SHLEK-së në Pejë 4607, SHLP-së në Gjakovë 8995, SHLP-së në Gjilan 45000 e QAL në Ferizaj 800. Bibliotekat kanë pasur edhe 229 tituj të periodikut: e SHLP-së në Pejë 6, SHLP-së në Gjakovë 22, SHLP-së në Prishtinë 25, SHLP-së në Prizren 36 e SHLP-së në Gjilan 140. Koleksionet e librit janë siguruar kryesisht përmes blerjes, por edhe përmes dhuratave. Po e zëmë biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prizren, gjatë periudhës 1962-1986, mesatarisht, ka blerë nga 1206 libra në vit.

Më 1986 bibliotekat e shkollave të larta kanë pasur 4487 përdorues: biblioteka e SHLP-së në Prishtinë 1705, SHLEK-së Pejë 26, SHLP-së në Prizren 406, SHLP-së në Gjakovë 778, SHLP-së në Gjilan 1272 dhe QAL në Ferizaj 300. Gjatë këtij viti janë lexuar 9334 libra. Anëtarët e regjistruar të bibliotekave, mesatarisht, kanë lexuar nga dy libra. Më se shumti është lexuar në Prizren e më se paku në Prishtinë.

Bibliotekat kanë pasur në shfrytëzim 13 lokale: nga katër lokale kanë pasur biblioteka e SHLP-së në Prizren e ajo në Gjilan, nga dy bibliotekat në Prishtinë e Gjakovë, një lokal e kishte biblioteka e SHLEK në Pejë. QAL e Ferizajt nuk kishte lokal të vaçantë për bibliotekë. Ato pak libra qëndronin në dy-tri regale në një lokal të Qendrës së Arsimit të Lartë. Sipërfaqja e të gjitha lokaleve bibliotekare rrokte 907 metra katrorë. Më se shumti lokal bibliotekar ka pasur biblioteka e SHLP-së në Prizren 448 metra katrorë, përkatësisht SHLP-së në Gjilan 326.

Këto biblioteka kanë pasur 7 salla të leximit për stu-

dentë: 2 ajo në Prizren, 3 në Gjilan e nga 1 kishin bibliotekat në Prishtinë e Gjakovë. Bibliotekat kishin 420 vende për lexim: 190 ajo në Gjilan, 160 në Prizren, 40 në Gjakovë e 30 në Prishtinë.

Bibliotekat e fakulteteve

Fakulteti i parë në Kosovë është çelur më 30.X.1960. “Menjherë pas themelimit të Fakultetit Filozofik formohen bibliotekat seminarike brenda këtyre grupeve: për Gjuhën dhe Letërsinë Serbokroatishte, Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, për Kimi dhe për Biologji me një fond të përgjithshëm prej 901 librash me vlerë 924351 dinarësh. Grupi për Matematikë dhe Fizikë nuk kanë pasur libra deri në fund të vitit 1961, kështu që nuk kanë pasur as biblioteka seminarike. Me rastin e themelimit të Fakultetit dhe të bibliotekave seminarike kanë munguar mjetet financiare për formimin e bibliotekave seminarike brenda katedrave ekzistuese në shumën prej 7000000 dinarësh të vjetër. Në fund të vitit 1961 janë formuar bibliotekat seminarike edhe në katedrat e tjera të Fakultetit Filozofik” (20). Dr. Idriz Ajeti, dr. Dervish Rozhaja e dr. Danilo Bajraktareviqi e kanë meritën kryesore për formimin e bibliotekave të para seminarike të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Rrjeti i bibliotekave të fakulteteve është formuar gjatë viteve 1960-1981.

Më 1986 kanë qenë 22 biblioteka të fakulteteve: 21 në Prishtinë e 1 në Mitrovicë: në Fakultetin e Xehetarisë e Metalurgjisë.

Më 1986 bibliotekat e fakulteteve kanë pasur 164639 libra: ato të Fakultetit Filozofik 48036, Fakultetit të Shkencave Natyrore e Matematikore 14145, Fakultetit Teknik 8400, Fakultetit të Arteve 2658, Fakultetit Juridik 13674, Fakultetit të Bujqësisë 4262, Fakultetit të Mjekësisë 50000, Fakultetit Ekonomik 15492, Fakultetit të Kulturës Fizike 1972 dhe Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë 6000. Për një student kanë rënë 6 libra.

Bibliotekat kanë pasur edhe periodikë të jashtme e të brendshme. Numri i titujve të periodikut ishte 1027, përkatësisht 58657 numra: 440 tituj i kishte Fakulteti Filozofik, 174 Fakulteti i Shkencave Natyrore e Matematikore, 31 Fakulteti Teknik, 15 Fakulteti i Arteve, 187 Fakulteti Juridik, 65 Fakulteti i Bujqësisë, 57 Fakulteti i Mjekësisë, 99 Fakulteti Ekonomik, e 8 tituj kishte biblioteka e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë.

Bibliotekat janë pasuruar me libra kryesisht përmes blerjes, por edhe përmes dhuratave. Po e zëmë bibliotekat e para seminarike të Fakultetit Filozofik të Prishtinës kanë marrë falas libra prej Muzeut Kombëtar të Bosnjës e Hercegovinës, “Matica Srpska” të Novi Sadit (810 kopje beletristikë e libra shkencorë), Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës etj.

Bibliotekat kanë pasur 39239 përdorues: bibliotekat e Fakultetit Filozofik 8648, bibliotekat e Fakultetit të Shkencave Natyrore e Matematikore 2745, biblioteka e Fakultetit Teknik 5720, biblioteka e Fakultetit të Arteve 420, biblioteka e Fakultetit Juridik 1656, bib-

lioteka e Fakultetit të Bujqësisë 755, biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë 13266, biblioteka e Fakultetit Ekonomik 3449, biblioteka e Fakultetit të Kulturës Fizike 80 dhe biblioteka e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë 2500.

Këto biblioteka kishin 36 lokale: Fakulteti Filozofik 10, Fakulteti i Shkencave Natyrore e Matematikore 6, Fakulteti i Mjekësisë 5, Fakulteti Ekonomik 4, Fakulteti Juridik 3, Fakulteti Teknik, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë nga 2, Fakulteti i Arteve dhe Fakulteti i Bujqësisë nga 1. Bibliotekat kanë pasur 19 salla për lexim, 2266 metra katrorë sipërfaqe, 1050 vende për studim.

#### Bibliotekat speciale

Formimi i rrjetit të bibliotekave speciale në Kosovë filloi më 15 prill 1946. Këtë vit “Komiteti Shqiptar i Rrethit të Prizrenit vendosi që të ngrihej një ndërtesë në vendin ku ishte mbajtur Lidhja e Prizrenit dhe atje të hapej biblioteka e Komitetit Shqiptar të Kosovës, për të cilën ishin mbledhur libra” (21).

Sipas punëtorit të parë të kësaj Biblioteke z. Nexhip Habipaj “Biblioteka ka qenë e vendosur në selinë e Komitetit Shqiptar në një ndërtesë dykatëshe diku në rrugën kryesore të qytetit të Prizrenit. Për bibliotekën na ishin dhënë dy-tri dhoma të vogla, me rreth tridhjetë metra katrorë, ku punohej gjithë ditën. Aty gjendej një tavolinë e ndonjë karrige. Në fillim biblioteka

kishte një 200 libra, kryesisht broshura e ndonjë gazetë e revistë, si “Lirija”, “Rilindja”, “Përparimi” etj”.

Më 1946 dihet edhe për punën e bibliotekës të Entit të Veterinarisë në Prishtinë.

Gjatë periudhës 1946-1956 formohen rreth tridhjetë biblioteka speciale (profesionale e të përgjithshme shkencore): në Entin për Mbrojtjen Shëndetësore në Pejë, Institutin për Plumb e Zing në Zveçan, Radio Prishtinë, Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë etj., kurse, gjatë viteve 1957-1967, formohen edhe pesëmbëdhjetë biblioteka speciale: në Institutin Bioteknik në Pejë, Kombinatit XMK “Trepça” në Mitrovicë, Institutin e Historisë në Prishtinë, Qendrën Mjekësore në Prizren, Shtëpinë Gazetare-Botuese “Rilindja” në Prishtinë, Kuvendin e KSA të Kosovës, Entin Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit në Prishtinë, Odën Ekonomike të Kosovës, Gjykatën Supreme të Kosovës etj.

Disa prej këtyre bibliotekave kishin numër të mirë të librave, lokale, pajisje etj. Kështu, biblioteka e Radio Prishtinës, Muzeut Krahinor dhe Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë, rreth vitit 1965, kanë pasur mbi 25000 libra. Është dalluar sidomos biblioteka e Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë. Vlera e librave të blera të kësaj biblioteke, kah fundi i vitit 1965, ka qenë mbi 15 milionë dinarë.

Biblioteka ishte e pasur sidomos me literaturë nga mjekësia e beletristika. Rreth vitit 1963 kjo bibliotekë morri 85 revista në gjuhë të huaja. Biblioteka kishte siguruar edhe karrocën speciale, që t’ua sillte librat, të

sëmureve, te shtrati. Për këtë bibliotekë është thënë edhe kjo: “Biblioteka e këtij spitali asht e vendosun në një lokal mjaft të përshtatshëm dhe e pajisun me një lokal mjaft modern”. Meritën për këto e kishte sidomos drejtori i Spitalit dr. Branko Zogoviqi.

Më 1986 në Kosovë kanë qenë 55 biblioteka speciale me 879000 njësi: libra e periodikë. Më 1978 bibliotekat kishin 468 tituj të periodikut të huaj të hyrë në biblioteka nga Shqipëria, Austria, Belgjika, Britania e Madhe, BRSS, Bullgaria, Çekosllovakia, Danimarka, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Italia, Izraeli, Japonia, Kanada, Norvegjia, Polonia, Rumania, Suedia, SHBA, Turqia, Zvicra etj (22).

Rrjeti i bibliotekave speciale nuk është zhvilluar paralel me numrin e institucioneve në Kosovë. Kuptohet numri institucioneve është më i madh.

Në vijim jemi ndalur te katër biblioteka speciale, karakteristike për kah karakteri, përmbajtja, struktura e koleksioneve, përdoruesve etj. të formuara gjatë viteve 1951-1976.

Biblioteka e Muzeut Krahinor

Është formuar më 1951 në Prishtinë. Që në fillim ka pasur numër të mirë të literaturës shkencore e historike të dhuruar kryesisht nga Akademia e Shkencave e Beogradit, Zagrebit e Lublanës, muzeve të Beogradit, Zagrebit, Sarajevës, Splitit dhe nga Shoqata e Historiografëve të Malit të Zi. Një pjesë e ktyre librave është blerë nëpër antikuare e nga personat privatë(23).

Biblioteka e Institutit Albanologjik të Prishtinës

Kjo bibliotekë është formuar më 1953. Me atë rast ka pasur numër të mirë të librave, meqë kishte trashëguar koleksionet e bibliotekës së Komisionit të Historisë të Pleqësisë Krahinore të Kulturës.

Më 25 dhjetor 1955 ndërprehet puna e IA të Prishtinës me çrast “u tretën shumë libra të bibliotekës së institutit dhe nuk iu kthyen atij as me rastin e rihapjes më 1967” (24).

Në shtator 1967 IA i Prishtinës e rifillon veprimtarinë tij shkencore albanologjike, bashkë me Bibliotekën e cila shpejt pasurohet me rreth 4000 libra e fotokopje të veprave të shkrimtarëve klasikë shqiptarë. Më 1977 kjo bibliotekë kishte 12000 libra shkencore, shumica nga albanologjia, monografi të ndryshme, botime serike, raporte nga tubimet shkencore e profesionale, mikrofilma, projekte hulumtuese etj. Prej koleksioneve të librit 2500 tituj ishin në gjuhë të huaja. Fondin e periodikut e përbënin 3000 numra.

Më 1986 biblioteka e Institutit Albanologjik të Prishtinës kishte 12750 kopje libri e 72 tituj të periodikut. Gjatë këtij viti ajo ka pasur 340 përdorues nga radha e profesorëve, studentëve e të tjerëve. Biblioteka kishte katër lokale bibliotekare, bashkë me sallën e leximit. Biblioteka, nga veprimtaria ndërbibliotekare, këmben informacione brenda e jashtë vendit.

Biblioteka e Fabrikës “Ramiz Sadiku” në Pejë

Është formuar më 1976. Më 1981 kishte rreth 10000 libra, kryesisht literaturë profesionale e beletristikë. Kishte sallën e leximit me 40 vende. Ka pasur në përdorim skedarin e autorit. Organizonte edhe aktivitete kulturore në bibliotekë: orë letrare, koncerte rtj.

Biblioteka e Industrisë së Gomës dhe Kimike “Ballkan” në Suharekë

Kjo Bibliotekë është formuar më 1974 me ndihmën e Bashkësisë Krahinore të Kulturës. Që nga formimi ajo i kushton kujdes të duhur pasurimit të koleksioneve bibliotekare me literaturë profesionale nga teknologjia e kauçukut dhe gomës, beletristikë e doracakë të ndryshëm. Gjatë vitit 1983 Biblioteka blen 980 libra në vlerë 201423 dinarë. Më 1984 numri i librave këtu arrin 11700 kopje: 9700 në gjuhën shqipe e 2000 në serbokroatishte. Kishte edhe 300 tituj të periodikut në gjuhën shqipe, serbokroatisht, anglisht, gjermanisht, frëngjisht, rusisht etj. Biblioteka ruan nga dy kopje të gazetës së Kolektivit “Ballkan” që nga numri i daljes më 1971. Në Bibliotekë punojnë dy punëtorë bibliotekarë në dy ndërresa. Biblioteka gjendet e vendosur në një lokal modern e të përshtatshëm për veprimtari bibliotekare me 120 metra katrorë. Ka edhe sallën e leximit me 50 karrige për lexuesit.

Biblioteka Qendrore e Lidhjes së të Verbërve të Kosovës

Është formuar më 1972 në Prishtinë pas decentralizimit të Bibliotekës Qendrore të Lidhjes së të Verbërve të Jugosllavisë në prill 1971.

Edhe përpara në Kosovë ka pasur biblioteka për të verbër. Më 1953 në Mitrovicë formohet një bibliotekë e këtillë brenda Entit për Aftësimin e të Verbërve, e cila kishte 32 libra sipas shkrimit në Braj. Që nga 1965 biblioteka kishte edhe abetaren e parë në gjuhën shqipe për të rritur të hartuar nga Tajar Hatipi e Faik Halili. Ky tekst ka qenë në përdorim deri më 1976.

Ndërkohë botohen edhe dy tekste për të verbër sipas shkrimit në Braj: Abetarja dhe Libër leximi për klasën e parë e të dytë të shkollimit fillor (special) të hartuara nga Abdyl Rama e Rexhep Hoxha.

Më 1967 në Kosovë kanë punuar katër biblioteka speciale për të verbër: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë e Prizren. Ato kanë pasur 415 libra në Braj e 77 përdorues (anëtarë).

BQLV e Kosovës, më 1977, kishte 939 libra në Braj e 178 njësi të tjera të sinkronizuara në shirita magnetofoni. Që nga viti 1985 BQLVK nxjerr revistën “Syri ynë” në teknikën akustike, në kaseta të veçanta, në tirazh 300 kaseta. Kasetat mund të dëgjohen, veç e veç, gjashtë orë. Më 1986 Biblioteka Qendrore e Lidhjes së të Verbërve të Kosovës kishte 583 tituj librash në Braj të incizuara në 1609 ekzemplarë, kryesisht beletristikë. Mbi 100 të këtyre titujve kanë qenë në gjuhën shqipe: 30 në kaseta e 70 në Braj. Kishte edhe rreth 500 tituj në serbokroatishte: 175 në kaseta e 300 në Braj.

Bibliotekat shkollore (të shkollave fillore e të mme)

Historikun e bibliotekave shkollore e kemi filluar me dy biblioteka të shkollave të mesme të formuara më 1946: biblioteka e sotme e QAM “Dimitrije Tucoviq” në Prizren dhe biblioteka e Shkollës Normale të Gjakovës.

Më 1954 figurojnë 124 biblioteka shkollore: 103 të shkollave fillore e 21 të shkollave të mesme. Këto biblioteka kanë qenë në shkollat e vendbanimeve: Zubin Potok, Zoqisht, Rahovec, Prishtinë, Suharekë, Mushtisht, Kamenicë, Hogosht, Vushtrri, Novosellë, Prilluzhë, Viti, Kabash, Pozhoran, Glllogoc, Runikë, Gjakovë, Gramaçel, Deçan, Rëzniq, Brezne, Brod, Brodosanë, Podujevë, Orllan, Llapashticë e Epërme, Istog, Klinë, Rakosh, Banjë e Pejës, Zallç, Shtupel, Lipjan, Janjevë, Lepinë, Magurë, Sedllar, Shtime, Prizren, Krushë e Madhe, Zhur, Korishë, Lubizhdë, Sreskë, Hoçë, Doganaj, Kaçanik, Shtërpçë, Han të Elezit, Jezerc, Talinovc etj. Ndërsa biblioteka të shkollave të mesme ka pasur në Gjakovë, Vushtrri, Gjilan, Prishtinë, Mitrovicë etj.

Më 1955 bibliotekat shkollore kanë pasur 87000 libra. Më 1956, sipas Xheladin Topçiu, gjendja e bibliotekave shkollore në Kosovë ka qenë e këfillë: prej 660 shkollave fillore, që punonin, vetëm 112 prej tyre kanë pasur bibliotekat e veta me fonde librash 100-150 dhe broshura. Ndërsa vetëm 45 biblioteka kanë marrë revista pedagogjike.

Në shkollat tetëvjeçare gjendja ka qenë diçka më e

mirë. Më tepër se gjysma e shkollave kanë pasur bibliotekat e veta mesatarisht me nga 3000-5000 libra e 8-14 revista (25).

Ndërkaq më 1965 numri i bibliotekave shkollore arrin në 314. Një bibliotekë ka rënë në 2.7 shkolla, përkatësisht 706 nxënës. Bibliotekat kanë pasur 281000 libra, 194000 më shumë se më 1955 ose 31 për qind.

Gjatë periudhës 1955-1974 me biblioteka bëhen edhe shkolla fillore “Emin Duraku” Glllogoc, “Musa Zajmi” Gjilan, “Xehetari” Hade, “Boro Vukmiroviq” e “Ramiz Sadiku” Pejë, “Mazllum Këpuska” Gjakovë, “Dositëj Obradoviq” Samodrexhë, “Zenel Hajdini” Goshicë, “Boris Kidriç” Vushtrri, “Pero Dapçeviç” Bishtazhin, “Emin Duraku” Orllat, “Vuk Karaxhiq”, “Vladimir Nazor”, “Aca Maroviç” e “Milladin Popoviç” Prishtinë, “Vëllaznim-Bashkim” Podujevë, “Emin Duraku” Kaçanik, “Emin Duraku” Novolan, “Vasilije Gjuroviç” Gjurakoc, “Sylë Alaj” Drenoc (komuna e Deçanit), “Shtëjfen Gjeçovi” Zym, “Rifat Shala” Bare, “Liria” Turiqec, “Vëllazërim-Bashkim” Suharekë, “Vuk Karaxhiq” Rahovec, “Rilindja” Malishevë, “Migjeni” Lubizhdë, gjimnazi “8 Nëntori” Podujevë, Liceu “Ivo Lola Ribar” Prishtinë, Gjimnazi në Kamenicë, shkolla teknike “Gani Çavdërbasha” Prizren, Shkolla Ekonomike në Vushtrri, gjimnazi “Ramiz Sadiku” Rahovec, Gjimnazi në Pejë, Shkolla Ekonomike në Gjilan, QAE e Profesioneve Mjekësore Prishtinë, gjimnazi “Xhevdet Doda” Prishtinë, QAMO “Marshali Tito” Kaçanik etj.

Mbështetur në numrin e librave, lokalitë bibliotekar

etj., gjatë periudhës kohore 1955-1974, janë dalluar biblioteka e Shkollës Normale në Prishtinë, biblioteka e Gjimnazit në Pejë me 12000 libra, biblioteka e gjimnazit “Vëllezërit Ribar” në Istog me 8000 libra, biblioteka e shkollës fillore “Zenel Hajdini” në Ujëmire, biblioteka e shkollës fillore “Vëllazërim-Bashkim” në Glllogoc, biblioteka e gjimnazit “8 Nëntori” në Podujevë me 5000 libra, ku për një nxënës kanë rënë 6.2 libra etj.

Gjatë dhjetëvjetëshit të tretë 1977-1986 formohen edhe rreth 20 biblioteka shkollore: pesë në Prishtinë: në shkollën fillore “Hasan Prishtina”, “Josip Broz Tito”, “1 Maj”, “Asim Vokshi”, “Vladimir I. Lenini”, shkollën fillore “J. B. Tito” Podujevë, “11 Tetori” Lubizhdë të Hasit, “18 Tetori” Polac, “Velko Banasheviq” Mitrovicë, “Zenuni” Brod të Dragashit, “Bajram Curri” Strellc të Epërm, “Rilindja” Açarevë të Skënderajt, “17 Nëntori” Prizren, “Bratstvo” Čerñicë të Gjilanit, QAMO “Jeta e re” Suharekë, QAMO “Luigj Gurakuqi” Klinë, QAMO “Emin Duraku” Dragash, QAMO “Velko Vllahoviq” Prishtinë etj.

Më 1986 figurojnë 321 biblioteka shkollore, të shkollave fillore e të mesme. Një bibliotekë ka rënë në 3.3 shkolla, përkatësisht 1346 nxënës. Bibliotekat kanë pasur 1238000 libra, 957000 më shumë se më 1965 ose 29 për qind. Për një nxënës kanë rënë 2.9 libra (26).

Furnizimi i bibliotekave, me libra e periodikë, është bërë përmes blerjes e dhuratave. Libra kanë blerë shkollat, por edhe komunat kanë ndarë shpesh mjete për këtë qëllim. Bibliotekat shkollore janë pasuruar edhe

përmes dhuratave nga ana e institucioneve, si Redaksia e botimeve Rilindja, Komiteti për Arsim, Shkencë e Kulturë i Kosovës, “Eksimkosi” etj. Libra kanë dhuruar edhe individët. Po e zëmë Fadil Hoxha, në dy raste, ka dhuruar 11500 libra: më 1979 ia dhuron 4500 libra bibliotekës së shkollës fillore “Fan Noli” në Viti të Marecit, kurse, më 1980, ia dhuron një bibliotekë (7000 njësi bibliotekare, bashkë me orenditë) shkollës fillore “Hasan Prishtina” në Tërpezë të Glllogocit. Ndërkaq bashkëshortja e shkrimtarit Hivzi Sulejmani, Mara Sulejmani, rreth vitit 1979, ia dhuron një bibliotekë (në vlerë 25000 dinarë) shkollës fillore “Hivzi Sulejmani” në Llazicë (komuna e Klinës), ndërsa, gjatë viteve 1980-1985, bibliotekës së shkollës fillore “Hasan Prishtina” në Prishtinë i dhurohen 424 libra nga qytetarët: Shaban Domi, Ali Podrimja, Adnan Shabani, Mustafa Kastrarti e Ali Krasniqi.

\*

Për ilustrim këtu e kemi veçuar Bibliotekën Shkollore të Qendrës Teknike Shkollore “Nikola Tesla” të Obiliqit.

Kjo bibliotekë është formuar më 1972 me kërkesën e Këshillit të arsimtarëve. Më 1986 ajo kishte rreth 8700 libra: 6000 në gjuhën shqipe ose 68.9 për qind e 2700 në gjuhën serbokroatishte ose 31 për qind. Pos letërsisë e literaturës tjetër, biblioteka është e pasur edhe me literaturë të elektronikës, makinerisë, xehetarisë etj. Biblioteka merr edhe disa tituj të periodikut: “Rilindja”, “Jedinstvo”, “Komunisti”, “Savremena

praksa”, “Rad” etj. Në bibliotekë ruhet edhe revista e shkollës “Horizonti”. Biblioteka ka punëtorin e përhershëm bibliotekar me orar të plotë pune në bibliotekë. Biblioteka bën inventarizimin e librave dhe mban skedarin sistematik sipas rregullave të Klasifikimit Universal Decimal (KUD-it). Librat jepen në lexim përmes reversit të plotësuar e të nënshkruar nga ana e lexuesit të librit. Gjatë vitit, në bibliotekë, regjistrohen rreth 2000 anëtarë, kryesisht nxëns e arsimtarë. Lokali i bibliotekës ka 40 metra katrorë sipërfaqe të shfrytëzuar për bibliotekë. Kjo bibliotekë bashkëpunon me bibliotekën publike të Bashkësisë lokale në Obiliq, bibliotekën e shkollës fillore “Vëllazërimi” në Obiliq dhe me disa biblioteka shkollore të Prishtinës (27).

- 
- <sup>1</sup>Knjizharski priručnik, Zagreb, [1955], f. 154-157. Botimin e ka hartuar Vladislav Shariq
  - <sup>2</sup>Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, 1984, f. 8; Enciklopedia e Jugosllavisë, botimi në gjuhën shqipe, 1 A-Bib, Zagreb, 1984, f. 719; Dr. Fehmi Pushkolli, Jeta dhe puna e të verbërve të Kosovës, Prishtinë, 1978, f. 63; Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë, 1999, f. 194
  - <sup>3</sup>Arkivi i Kosovës, [ material buxhetor ], Prishtinë, 1947, Part. 144, f. 16
  - <sup>4</sup>Bilten bibliotekog Centra AKMO-Prishtina 1959, Nr. III, f. 14
  - <sup>5</sup>Sluzhbeni list AKMO, broj 39 od 6 decembra 1961
  - <sup>6</sup>Sluzhbeni list Socijalističke Autonomne Pokrajine Kosova, Nr. 24/1970, f. 729 (Zakon o osnivanju Narodne i Univerzitetske Biblioteke Kosova)

- <sup>7</sup>Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, prijemi inventar poklonjenog fonda za godine 1962-1986; Inventari i pranimit për libër të blerë për vitet 1973-1986; Inventari i pranimit për libër të blerë për vitet 1962-1986; Inventari i pranimit për librat e këmbyer për vitet 1973-1977, 1980, 1984- 1986
- <sup>8</sup>“Përparimi”, Prishtinë, 1957, Nr. 10, f. 705.
- <sup>9</sup>Mr. Tahir Foniqi, Biblioteka komunale e Prizrenit. “Shkëndija, 1 mars 1990, f. 7; Monografi për Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, Prizren, 2004, f. 23-25
- <sup>10</sup>“Rilindja”, Vjeti I, Numër 1, 12 Fruer 1946, f. 4
- <sup>11</sup>“Përparimi”, Prishtinë, 1956, Nr. 2, f. 139
- <sup>12</sup>“Rilindja”, 21 Qersher 1946, f. 5
- <sup>13</sup>Arkivi komunal i Prishtinës, Procesverbal nga mbledhja e Pleqësisë për Arsim, Shkencë e Kulturë e K. P. të rrethit të Prishtinës më 18 prill 1953; Procesverbal nga mbledhja e gjashtë për Arsim e Kulturë e Këshillit Popullor të rrethit më 3.XII.1954, kutia 21
- <sup>14</sup>Adem Bllaca, Biblioteke Kosova i Metohije u periodu od 1948-1958 god. “Bibliotekar”, Beograd, 1958, 1-2, f. [59]
- <sup>15</sup>Vodič kroz narodne biblioteke Jugoslavije, Beograd, 1979, f. 402-424. Numri i banorëve në Kosovë i referohet vitit 1971, ndërsa numri i vendbanimeve vitit 1976. Më 1971 Kosova kishte 1243693 banorë. VSK-86, f. 28
- <sup>16</sup>Esad Kamberi, Zhvillimi i kulturës në pesëvjeçarin e kaluar. “Fjala”, Prishtinë, 1981, nr. 22, f. 2
- <sup>17</sup>Shënimet për numrin e bibliotekave publike për 1986 janë marrë nga burimet: Radovan Kompiroviq, Libri pa kopertina. “Komunisti”, 1988, Nr. 535, f. 13; VSK-76, f. 450; Sylejman Pireva, Reformë për kthesa pozitive. “Rilindja”, 16.I.1989, f. 14
- <sup>18</sup>Ismet Spahiu, Razvoj i problemi biblioteka u 1965. godini. “Nasha praksa”, Prishtina, 1966, 1-2, f. 6
- <sup>19</sup>SHLP Prishtinë, Jubile (1958-1973), Jeta dhe puna e shkollës në fotografi, Prishtinë, 1974, f. 40. Në vitin stu-

- dentesk 1958/59 Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë ka regjistruar 144 studentë: 90 të rregullt e 54 me korrespondencë
- <sup>20</sup> Deset godina rada Filozofskog Fakulteta u Prishtini, Prishtina, novembra, 1971, f. 96
- <sup>21</sup> Dr. Fehmi Pushkolli, Formimi i Komitetit Nacional të Shqiptarëve të Kosovës dhe veprimtaria e tij 1945-1947. Separat nga revista "Kosova", 15, Prishtinë, 1986, f. 117
- <sup>22</sup> Vodič kroz Informacijko-Dokumentacijsko-Komunikacijske Sluzhbe i Specijalne Biblioteke u SFRJ, Zagreb, 1983, f. 1-145. Numri i librave është marrë nga burimi: Statistički Godishnjak SR Srbije 1987, Beograd, 1987, f. 624
- <sup>23</sup> Hasan Mekuli, Muzeumi Populluer Krahinuer në Prishtinë, "Jeta e re", Prishtinë, 1950, 1-2, f. 408
- <sup>24</sup> Njëzet vjet të Institutit Albanologjik (1967-1987), botim jubilar, Prishtinë, 1987, f. 13
- <sup>25</sup> "Përparimi", 1957, Nr. 1-2, f. 99-100
- <sup>26</sup> Enti Statistikor i KSA të Kosovës, Buletini numër 78, f. 11, 19-21. Në vitin shkollor 1985/86 në Kosovë kanë qenë 1048 shkollat: 944 fillore e 104 të mesme. Shkollat kanë pasur 431959 nxënës: 346409 të shkollave fillore e 85550 të shkollave të mesme. Numri i bibliotekave dhe i librave janë marrë nga VSK-87, f. 316
- <sup>27</sup> Shënimet na i ka ofruar Sh. Kastrati punëtor bibliotekar i bibliotës së shkollës

## STRUKTURA E KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKAVE

Për shkak të veprimtarisë së varfër botuese në Kosovë deri vonë, sidomos në gjuhën shqipe, që zgjat deri kah fillimi i viteve të 70, furnizimit shpesh stihik të bibliotekave me material bibliotekar e një varg dobësish organizative në linjat e furnizimit, koleksionet e bibliotekave tona konsiderohen të varfëra. Këto e çështje të tjera kanë qenë shpesh tema diskutimi në forume të ndryshme bibliotekare, si në Lidhjen Krahinore të Bibliotekave dhe Organizatave për Përhapjen e Librit, Bashkësinë e Institucioneve të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës etj. Kështu, në një mbledhje të Lidhjes Krahinore të Bibliotekave, mbajtur në Prishtinë, në gjysmën e parë të vitit 1958, është thënë: "Në diskutimin që u zhvillue në lidhje me këte dhe me çashtjet e tjera, u theksue nevoja për pasunimin e bibliotekave dhe sallave të leximit sidomos

me botime të reja dhe libra në gjuhën shqipe” (1). Në një rast tjetër është thënë kjo: “Në kohë të fundit posta drejtuar Bibliotekës Krahinore nuk arrin kurrsesi në duart tona. Po e ndalojnë ndokund. Rrallëherë arrin revistë, apo gazetë” (2).

Kah fillimi i viteve të 50, në Kosovë, fillojnë të botohen tekstet e para shkollore me autorë shqiptarë, përkatësisht titujt e parë të beletistikës origjinale shqiptare të formës libër.

Duke u nisur nga vitet e 70 koleksionet e bibliotekave tona pasurohen dukshëm me literaturë në gjuhën shqipe, kur intensifikohet edhe veprimtaria botuese origjinale shqipe në Kosovë, Maqedoni etj.

Më 1986 bibliotekat kanë pasur 4670388 libra, 23950 tituj të periodikut e rreth 8000 njësi jolibër (3).

Struktura e koleksioneve të librit

*Struktura e koleksioneve të librit të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës sipas KUD-it (Klasifikimi Universal Decimal)*

Në mbarim të vitit 1986 BPU e Kosovës kishte rreth 563828 libra nga të cilat 387089 kanë pasur këtë përberje sipas KUD-it.

	Nr. i vëllimeve	Përqindja
Grupi i përgjithshëm	2924	1.5%
Filozofia	4645	2.4%
Religjioni	611	0.3%
Shkencat shoqërore	49581	25.7%

Shkencat natyrore	12505	6.5%
Shkencat e aplikuara	58061	30.1%
Arti	4507	2.3%
Letërsia, Gjuhësia	51634	26.8%
Historia, Gjeografia	8139	4.2%

Mbështetur në këto shifra del se, në BPU të Kosovës, më 1986, ka dominuar literatura nga shkencat shoqërore: sociologjia, ekonomia, drejtësia, arsimiti, përkatësisht letërsia e gjuhësia, shkencat e aplikuara dhe shkencat natyror, ndërsa, më me pak, ka qenë literatura fetare e literatura nga grupi i përgjithshëm e filozofia.

Këto koleksione janë kryesisht botime të reja, të cilat kanë hyrë në këtë Bibliotekë, përmes kopjes së detyruar në ish-Jugosllavi e formave të tjera të furnizimit: blerjes, dhuratave, këmbimit etj.

Sipas një shkrimi të Shkëlzen Maliqit, në këtë Bibliotekë, “Përqindja e botimeve të të gjitha fondeve të para vitit 1962, sipas një llogaritjeje të thjeshtë, s’mund të jetë më e madhe se 2,5 për qind. Përqindja e botimeve në gjuhë të huaja është edhe më e vogël. Sa u takon rariteteve, ato mezi kapin 1 për qind të fondit të përgjithshëm” (4).

Biblioteka ka numër të mirë të dorëshkrimeve e të librave të vjetër e të rrallë, që nga shekulli XVII, si Della historia Vinetiana di paolo parvta cavaliere, et procvratore di San Marco, in Venetia, MDCV [ 1605 ] (III R-1170), Gezetse und Verordnungen Justiz-Sache : fur Kaiserthum Osterreich, 19, Vjenë, 1859 (II 2552), Naim Frashëri, Parajsa dhe fjala fluturake : vjersha,

Korçë, 1894 (II 249), Blagoje Brantiq..., Srpsko-magjarski rečnik = Szerb-magyar szotar, Novi Sad, 1894 (II 500 P), Anatole France, Les sept femmes de la barbe bleue et autres contes merveilleux, Paris, 1909 (II 66009), Graham Wallas, Politik und menschliche nature, Jenë, 1911 (66104), Zhivojin Daçiq, Kako moj zhive : proste priçe iz zhivota nashega naroda, Beograd, 1912 (II 5490/6), Andre Salmon, Histoires de Boches, Paris, 1917 (II 66100), K. A. Çekrezi, Historia e re e Evropës, Boston, 1921 (II 25899), Gavro Manojloviç, Povijest staroga orienta I, Zagreb, 1923 (II 1794), Sekula Drljeviq, Centralizam ili federalizam?, Zemun, 1926 (II 3499), Shqipnija para dy shekujsh, Tiranë, 1930 (II 23801), Vaso Pashko, E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët, Tiranë, 1933 (II 24463), Emilio Bodrero, Kriza demokracije, Beograd, 1938 (II 6238), Emzot Pjetër Bogdani, "Cuneus prophetarum" / a se / Çeta e profetve /, çitë n'alfabetin e soçëm e kthiellue me vrojtime prej at Mark Harapit I, Shkodër, 1940 (II 287), Rastislav Drljiq, Prvi ilir Bosne Fra Nediq (1810-1895), Sarajevo, 1940 (II 5467), Luigj Filip, "Burgu i dashtunis (prej jetës të Franz Schubertit)", Tiranë, 1942 (II 23456) etj (5).

Në BPU të Kosovës ruhet edhe fotokopja e romanit, në vargje, Florimont, me syzhe shqiptar-ballkanik i shekullit XII, shkruar, në gjuhën e vjetër frënge, nga Aimon dë Varenes, botuar në gjermanishte në Gotingen më 1932. Këtë kopje e ka sjellë në Bibliotekë Hajdar Domi. Një fotokopje të këtij romani, në Kosovë, e ka sjellë edhe Rexhep Thaçi nga Prizreni.

Struktura e koleksioneve të librit të bibliotekave publike sipas gjuhëve

Më 1959 bibliotekat publike kanë pasur 249883 kopje të librave: 182250 në gjuhën serbokroatishte ose 72.9 për qind, 65785 në gjuhën shqipe ose 26.3 për qind e 1848 në gjuhët e tjera ose 0.74 për qind.

Literatura në serbokroatishte ka dominuar në komunat: Viti, Vushtrri, Glllogoc, Gjilan, Deçan, Dragash, Gjakovë, Zubin Potok, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë, Leposaviq, Lipjan, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prizren, Prishtinë, Skënderaj, Suharekë, Ferizaj e Shtërpçë. Vetëm në tri komuna ka pasur më shumë libra në gjuhën shqipe: Zym, Klinë e Malishevë, kurse në tri komuna s'kishte libra shqipe: Dragash, Zubin Potok e Shtërpçë.

Mungesa e literaturës shqipe, në këtë tip të bibliotekave, ka qenë e pranishme gjithë deri kah gjysma e viteve të shtatëdhjeta. Kështu më 1963 bibliotekat kishin 301000 libra: 208000 në serbokroatishte ose 69.1 për qind, 82000 në shqipe ose 27.2 për qind e 11000 në gjuhët e tjera ose 3.7 për qind.

Më 1986 bibliotekat kanë pasur 1722509 libra: 1194915 në gjuhën shqipe, ose 69.4 për qind, 506325 në gjuhën serbokroatishte ose 29.4 për qind, 17445 në gjuhën turqishte ose 1 për qind e 3824 në gjuhët e tjera ose 0.2 për qind. Për kokë të banorit, në Kosovë, kanë rënë 1.08 për qind: te popullata shqiptare 0.97, te popullata serbe e malazeze 2.1 për qind, te popullata turke 1.4 për qind e te popujt e tjerë 0.04 për qind.

Bibliotekat e komunave, veç e veç, kanë pasur këtë përbërje gjuhësore të librave: Deçani 45584 në gjuhën shqipe e 11335 serbokroatishte, Dragashi 37937 shqipe e 53 turqishte, Ferizaj 32579 shqipe e 23250 serbokroatishte, 106 turqishte e 10 në gjuhët e tjera, Gllgocci 53425 shqipe, 17720 serbokroatishte, Gjakova 50503 shqipe 15484 serbokroatishte e 58 në gjuhët e tjera, Gjilani 94034 shqipe, 46707 serbokroatishte, 2980 turqishte e 100 në gjuhët e tjera, Istogu 41784 shqipe, 15984 serbokroatishte, 106 turqishte e 10 në gjuhët e tjera, Kaçaniku 37841 shqipe, 3645 serbokroatishte, 54 turqishte e 15 në gjuhët e tjera, Kamenica 48117 shqipe, 20807 serbokroatishte e 750 në gjuhët e tjera, Klina 32610 shqipe, 14341 serbokroatishte, 53 turqishte e 3 në gjuhët e tjera, Leposaviqi 669 shqipe e 20550 serbokroatishte, Lipjani 66859 shqipe, 19340 serbokroatishte, 106 turqishte, Mitrovica 66684 shqipe, 41382 serbokroatishte, 1939 turqishte e 475 në gjuhët e tjera, Peja 40362 shqipe, 34018 serbokroatishte, 55 turqishte e 320 në gjuhët e tjera, Prishtina 181659 shqipe, 123131 serbokroatishte, 2001 turqishte e 2001 në gjuhët e tjera, Prizreni 47082 shqipe, 33161 serbokroatishte, 6781 turqishte e 72 në gjuhët e tjera, Podujeva 99049 shqipe, 15620 serbokroatishte, 112 turqishte e 10 në gjuhët e tjera, Rahoveci 21098 shqipe, 8306 serbokroatishte e 45 në turqishte, Skënderaj 44024 shqipe e 11384 serbokroatishte, Suhareka 41735 shqipe, 8650 serbokroatishte e 100 turqishte, Vitia 43195 shqipe, 112 turqishte dhe Vushtrria 63644 në gjuhën shqipe, 13183 në serbokroatishte e 524 në turqishte.

Më 1986, në 21 komuna, ka dominuar literatura në gjuhën shqipe, ndërsa në një komunë ajo në gjuhën serbokroatishte: në Leposaviq.

Gjatë vitit 1986 janë blerë 52044 libra: 39662 në gjuhën shqipe, 11736 serbokroatishte e 646 në turqishte, kurse, të papërdorshme, janë nxjerrë 3818 libra: 2942 shqipe e 876 serbokroatishte (6).

Struktura e librit të bibliotekave publike sipas KUD-it

Në mbarim të vitit 1976 bibliotekat publike kanë pasur 913820 vëllime të librave, prej tyre 678130 kishin këtë përbërje sipas KUD-it.

	Nr. i vëllimeve	Përqindja
Grupi i përgjithshëm	25711	3.8%
Filozofia	7580	1.1%
Religjioni	2812	0.4%
Shkencat shoqërore	76814	11.3%
Shkencat natyrore	37050	5.4%
Shkenat e aplikuara	38952	5.7%
Arti	10943	1.6%
Letërsia, Gjuhësia	442953	65.3%
Historia, Gjeografia	35315	5.2% (7).

Në këtë periudhë printe letërsia e gjuhësia me 65.3 përqind, përkatësisht literatura nga shkencat shoqërore, shkencat e aplikuara, historia e gjeografia dhe grupi i përgjithshëm, kurse literatura fetare e filozofia kanë qenë në sasi më të vogël.

Struktura e koleksioneve të librit të bibliotekave universitare sipas KUD-it

Më 1986 bibliotekat universitare kanë pasur 267051 libra, bashkë me separate, ku dominonte literature nga lëndët uiversitare. Nga këto libra 192607 kishin këtë përbërje sipas KUD-it.

	Nr. i vëllimeve	Përqindja
Grupi i përgjithshëm	2924	1.5%
Filozofia	4645	2.4%
Religjioni	611	0.3%
Shkencat shoqërore	49581	25.7%
Shkencat natyrore	12505	6.5%
Shkencat e aplikuara	58061	30.1%
Arti	4507	2.3%
Letërsia, Gjuhësia	51634	26.8%
Historia, Gjeografia	8139	4.2%

Këtu printe literatura nga shkencat e aplikuara me 30.1 për qind, letërsia e gjuhësia 26.8 për qind, shkencat shoqërore 25.7 për qind etj. Ndërsa më se paku literaturë kishte nga teologjia 0.3 për qind.

Struktura gjuhësore e koleksioneve të bibliotekave shkollore

Në vitin shkollor 1961/62, 155 biblioteka të shkollave: fillore e të mesme, të anketuara me këtë rast, kanë pasur 13895 libra me këtë përbërje gjuhësore: 9773 në gjuhën serbokroatishte ose 70.3 për qind, 3978 në gjuhën shqipe ose 28.6 për qind e 144 në gjuhët e tjera ose 1 për qind. Rreth 75-85 për qind e këtij fondi ishte beletristikë, 10-12 për qind literaturë politike, 9-12 për

qind tekste shkollore e doracakë e 3-5 për qind literaturë e popullarizuar.

Gjatë vitit shkollor 1972/73 bibliotekat e shkollave fillore kishin 99819 libra: 81.24 për qind në tri gjuhë: shqipe, serbokroatishte e turqishte, kurse bibliotekat e shkollave të mesme kanë pasur 43393 libra: në gjuhën shqipe, serbokroatishte e turqishte.

Gjatë vitit 1972/73 bibliotekat shkollore (fillore e të mesme) janë pasuruar me 21904 libra (8).

Më 1986, 24 biblioteka: 16 të shkollave fillore e 8 të shkollave të mesme, të cilat i kemi hulumtuar, kanë pasur 137166 libra me këtë përbërje gjuhësore: 88838 në gjuhën shqipe ose 64.7 për qind, 46142 në gjuhën serbokroatishte ose 33.6 për qind, 1126 në gjuhën turqishte ose 0.8 për qind e 1060 në gjuhët e tjera ose 0.8 për qind. Rritje e numrit të librave është shënuar sidomos gjatë viteve 1980, 1983 e 1986.

Struktura e periodikut

Bibliotekat në Kosovë, paralel me librin e me materialin tjetër bibliotekar, janë furnizuar edhe me periodikë: gazeta, revista, fletushka, buletine, vjetarë, shtojca speciale etj. Përmbajtja e kësaj literature është letrare, profesionale, shkencore, fetare, argëtuese etj.

Struktura e periodikut të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës

BPU e Kosovës furnizohet me periodikë, që nga viti 1962. Nga kjo kohë këtu ka hyrë shumica e periodikut

shqip, botuar në Kosovë e më gjerë, madje edhe gazetave lokale, fletushkat e klubeve letrare, fletushkat e shkollave etj. Ne nuk e kemi gjetur këtu ndonjë titull periodiku të kompletuar gjatë periudhës sonë në shqyrtim 1944-1986. Këtu mungojnë edhe gazetave "Toska" e "Albania", që kanë dalë në Beograd gjatë viteve 1901-1907, të cilat i drejtonte grupi i intelektualëve shqiptarë të prirë nga publicisti i njohur i kohës Jashar Erebara.

Nga periodiku biblioteka ruan edhe botime dhe origjinale të këtyre titujve të hershëm: "Letopis Matice Srpske", Novi Sad, 1874, "Fiamuri Arbërit", Corigliano Calabro", 1883, "Mjesečnik Pravničkoga Drushtva u Zagrebu", Zagreb, 1891, "Učitelj", Beograd, 1895, kopjet "Albania" të Faik Konicës, Bruksel, 1897, "Shqipëria", Bukuresht, 1897, "Tone tes albanias", Athinë, 1897, "Arhiv za pravne drushtvene nauke", Beograd, 1909, "Dituria", Selanik, 1909, "Rrufeja", Egjipt, 1909, "Tomorri", Elbasan, 1910, "Nastavni vjesnik", Zagreb, 1912, "Hylli i dritës", Shkodër, 1920, "Mesični prehled za hroničniho obchodu Republiky Československe, Pragë, 1925, "Fletore e së Diellës", 1930, "Përpyekja shqiptare", 1936, mikrofilmat e gazetave "Kombi" e "Dielli" etj.

Biblioteka ruan shumicën e titujve të periodikut të botuar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, si "Rilindja", "Përparimi", "Jeta e re", "Pionieri", "Gjurmime albanologjike", "Biblioteka", "Dituria islame" "Flaka e vëllazërimit", "Jehona", "Gëzimi", "Koha" etj.

Kah fundi i viteve të '70 BPU e Kosovës ka pasur

12000 blenjtë të periodikut, të hyrë, kryesisht, përmes ekzemplarit të obligueshëm. Nga Shqipëria hynin 33 tituj në tri kopje.

Në mbarim të vitit 1986, numri i titujve të periodikut në bibliotekë, arrin në 9784: 6888 të revistave e 2896 të gazetave në disa gjuhë: shqipe, serbokroatishte, sllovenishte, maqedonishte, frëngjishte, anglishte, gjermanishte, arabishte, turqishte, italishte, rusishte, polake, hungarishte, bullgarishte, rumune, greqishte etj (9).

Kuptohet këtu nuk janë përfshirë fletushkat me karakter jubilar e materialet e shaptilografuara, fletushkat zyrtare të organizatave punuese, botimet efemere (afatshkurtëra) etj.

Struktura e periodikut të bibliotekave publike sipas gjuhëve

Që më 1954 biblioteka në Brodosanë, komuna e Dragashit, merrte disa tituj të botimeve serike e 11 numra të gazetës "Rilindja". Kurse biblioteka në Gjilan ka marrë mbi 10 tituj të gazetave ditore e disa tituj të revistave. Ndërkaq më 1964 biblioteka e Muçivercës, komuna e Kamenicës, merrte gazetave: "Rilindja", "Borba", "Politika" e "Sport i svet". Më 1968 biblioteka e Prilluzhës, komuna Vushtrrisë, ka marrë revistat: "Jeta e re" dhe "Zëri i Rinisë". Kurse, më 1973, biblioteka në Kijevë, komuna e Klinës, merrte revistën e ilustruar "Zëri i Rinisë" dhe gazetën "Jedinstvo" të Prishtinës. E më 1974 biblioteka në Skënderaj ka marrë gazetave e revistat: "Rilindja", "Jedinstvo", "Jeta e re", "Përparimi", "Shkëndija", "Novosti", "Sporti",

“Arena” etj.

Më 1976 bibliotekat kanë pasur 381 tituj të periodikut: 3 biblioteka e Suharekës, 5 ajo e Vushtrrisë, 6 e Vitisë, 7 e Leposaviqit, 9 e Deçanit, 10 e Rahovecit, nga 11 e Istogut, Gjakovës dhe e Skënderajt, 14 e Lipjanit, 15 e Dragashit, nga 16 e Kaçanikut dhe e Podujevës, nga 17 e Klinës dhe e Mitrovicës, nga 22 e Prishtinës dhe e Ferizajt, 24 e Kamenicës, nga 32 e Prishtinës dhe e Glllogocit, 43 e Pejës e 67 biblioteka e Gjilanit.

Më 1986 bibliotekat e shtojnë numrin e titujve të periodikut për 45, në krahasim më 1976, ose 10.6 për qind. Struktura gjuhësore e këtij periodiku ka qenë: 196 në gjuhën shqipe ose 46. 2 për qind, 212 në gjuhën serbokroatishte ose 49.8 për qind, 14 në gjuhën turqishte ose 3.3 për qind e 3 në gjuhët e tjera ose 0.7 për qind.

Periodikë shqipe s’ kanë pasur bibliotekat e komunës së Kamenicës, Leposaviqit e Skënderajt, ndërsa periodikë në gjuhën serbokroatishte nuk kishin bibliotekat e komunës së Glllogocit, Gjakovës, Kamenicës e Skënderajt. Vetëm pesë biblioteka komunale kanë pasur ndonjë titull në gjuhën turqishte: e Gjilanit, Mitrovicës, Prishtinës, Prizrenit dhe e Vushtrrisë. Tre tituj të periodikut, në gjuhë të huaja, i kishte biblioteka e Prishtinës.

Struktura gjuhësore e periodikut të bibliotekave universitare

Shënimet e para, për periodikun në bibliotekat universitare, i gjejmë më 1978 dhe kjo vetëm për periodikun e jashtëm. Në mbarim të këtij viti 20 biblioteka univer-

sitare kanë pasur 685 tituj të periodikut të jashtëm 1 deri 218 tituj. Më se shumti tituj kishte biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë 218, ndërsa më se paku biblioteka e Degës së Historisë 1 (10).

Ndërkaq më 1986 këto biblioteka kishin 1227 tituj të periodikut, vendor e të jashtëm, në 62963 ekzemplarë, me këtë përbërje gjuhësore: 160 në gjuhën shqipe ose 13 për qind, 629 në gjuhën serbokroatishte ose 51.3 për qind, 97 në gjuhën anglishte ose 7.9 për qind, 35 në gjuhën frëngjishte ose 2.8 për qind, 29 në gjuhën italishte ose 2.4 për qind, 183 në gjuhën rusishte ose 14.9 për qind, 6 në gjuhën turqishte ose 0.5 për qind, 31 në gjuhën gjermanishte ose 2.5 për qind e 36 në gjuhët e tjera ose 2.9 për qind.

Në këtë periudhë, më se shumti tituj të periodikut, ka pasur biblioteka e Fakultetit Juridik 187, ndërsa, më se paku, kishte biblioteka e Degës Gjuhë Frënge dhe Letërsi 4.

Biblioteka e Fakultetit Juridik edhe ekzemplarë periodiku ka pasur më se shumti 10795, kurse, më se paku ekzemplarë, ka pasur biblioteka e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë 8.

Bibliotekat, me periodikë, janë furnizuar kryesisht përmes blerjes e dhuratave. Kështu, biblioteka e Degës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, gjatë vitit 1986, ka blerë 6 tituj të revistave: 5 në gjuhën shqipe: “Përparimi”, “Jeta e re”, “Jehona” (Shkup), “Koha” (Titograd), “Gjurmime albanologjike” tri seritë: filologji, histori, folklore dhe etnologji e 1 titull në gjuhë të huaj.

Ne kemi, gjithashtu, shënimin se biblioteka e Degës

Gjuhë Shqipe dhe Letërsi ka marrë falas disa numra periodiku nga profesorët Isak Shema, Shefqet Pllana, Rexhep Ismaili, Fadil Raka etj (11).

Struktura e periodikut të bibliotekave shkollore (fillore e të mesme)

Në vitin shkollor 1961/62, 88 biblioteka, nga 155 të anketuara me këtë rast, kanë qenë të parapaguara në 12 tituj të periodikut: 1 në gjuhën shqipe e 12 në serbokroatishte: “Përparimi”, “Prosvetni pregled”, “Nasha shkola”, “Nastava i vaspitanja”, “Pedagogshki rad”, “Savremena shkola”, “Prosvetni glasnik” etj.

Ndërkaq më 1972/73 bibliotekat kanë pasë 12513 vëllime me periodikë: 6489 bibliotekat e shkollave fillore e 6024 bibliotekat e shkollave të mesme. 53.1 për qind e këtij periodiku ka qenë për fëmijë.

Vetëm gjatë këtij viti bibliotekat janë pasuruar edhe me 3466 vëllime të periodikut: 1913 bibliotekat e shkollave fillore e 1553 bibliotekat e shkollave të mesme.

Koleksionet jolibër të bibliotekave (të të gjitha tipave)

Bibliotekat në Kosovë janë furnizuar edhe me material bibliotekar jolibër: harta, globusë, disqe, kartolina, gravura, pllakate, filma, mikrofishe, muzikalie, përmbledhje me shkrimin në Braj, kalendarë etj.

Pjesa më e madhe e këtij materiali gjendet në Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Kosovës.

Dihet për rreth 900 përmbledhje me shkrimin në Braj, 2000 njësi muzikalie, 2000 kartolina, disa shirita magnetofoni, ku veçojmë atë me zërin e aktorit tonë me famë botërore Aleksandër Moisiut etj.

Më 1986, ndërkaq, biblioteka e Degës së Gjeografisë në Prishtinë kishte 1000 harta topografike apo biblioteka e Degës Gjuhë Frënge dhe Letërsi kishte diafilmat për mësimin e gjuhëve të huaja, kurse biblioteka e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjilan ka pasur 2 harta, 1 glob e 1 disk. Në anën tjetër Biblioteka Qendrore e Lidhjes së të Verbërve të Kosovës në Prishtinë kishte 583 tituj të librave në Braj e të incizuara në 1609 kopje, kryesisht beletristikë. Ajo ruan edhe disa numra të revistës “Syri ynë” e cila botohet në teknikën akustike që nga viti 1985.

Edhe bibliotekat shkollore kanë pasë njësi jolibër, por në sasi të vogla. Në vitin shkollor 1972/73 bibliotekat kishin 446 njësi: 294 bibliotekat e shkollave fillore e 152 bibliotekat e shkollave të mesme. Gjatë këtij viti bibliotekat pasurohen edhe me 199 njësi të tjera: 105 bibliotekat e shkollave fillore e 94 bibliotekat e shkollave të mesme.

Sa i përket materialit të imët, në bibliotekat tona, madje edhe në BPU të Kosovës, gjatë kohës për të cilën bëhet fjalë këtu, ai është trajtuar si “lëndë e paregjistruar”.

1. "Jeta e re", Prishtinë, 1958, 3, f. 387
2. Kuvendi i Katërt i Bashkësisë së Institucioneve të KSAK, Buletini III, Prishtinë, 1970, f. 65 (Nga diskutimi i Ismet Spahiut, drejtor i Bibliotekës Krahinore gjatë periudhës 15 maj 1968-31 janar 1973).
3. Numri i titujve të periodikut, te bibliotekat speciale, është dhënë bashkë me numrin e librave, ndërsa gjendja e periodikut, te bibliotekat shkollore, i referohet vitit shkollor 1972/73
4. Shkëlzen Maliqi, Ndriçimi i shkrimeve të së kaluarës, "Fjala", Prishtinë, 1985, Nr. 2, f. 2
5. Këta tituj janë marrë nga fondet e përgjithshme të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës përpara vitit 1986
6. Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Seksioni për Përparimin e Veprimtarisë Bibliotekare, Vjetar statistikor për bibliotekat popullore të Kosovës për vitin 1986. Numri i banorëve është marrë nga burimi: Kosovo u brojkama 1987, Prishtina, februar 1988, f. 21 dhe i referohet vitit 1981
7. Vodič kroz narodne biblioteke Jugosllavije, Beograd, 1979, f. 424
8. "Nasha praksa", Prishtina, 1962, Broj 2, f. 49; "Zajednica biblioteka", Beograd, 1975, 3, f. 49-60; 79-89
9. Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Sektori i periodikut, Inventari i signaturës për revista e gazeta
10. Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Qendra për Informata Shkencore dhe Veprimtari Referale, Fasikla: material i kryer-skeda të plotësuar të revistave
11. Nga dokumentacioni i bibliotekës së Degës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në Prishtinë

## STRUKTURA E PËRDORUESVE (LEXUESVE) TË BIBLIOTEKAVE

**N**umri më i madh i përdoruesve (lexuesve) në Kosovë përbëhet nga nxënësit dhe studentët. Pasonjë, tevona, punëtorët shkencorë, nëpunësit, punëtorët, bujqit, amviset etj. Rreth vitit 1970, 81 për qind të përdoruesve kanë qenë nga radha e nxënësve, të cilët kanë dominuar në bibliotekat shkollore e publike, ndërsa studentët e punëtorët shkencorë dominonin në Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Kosovës, bibliotekat universitare dhe në bibliotekat speciale. Kategoritë e tjera të lexuesve kanë frekuentuar në bibliotekat publike.

Struktura e përdoruesve të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës

Në mbarim të vitit 1962 kjo Bibliotekë ka pasur të anëtarësuar 3586 studentë. Ndërkaq, gjatë periudhës

1963-1973, Biblioteka e shton numrin e përdoruesve, si vijon: 1963-4217, 1964-4846, 1965-5488, 1966-7090, 1967-8690, 1968-11092, 1969-13301, 1970-16193, 1971-18840, 1972-19570, 1973-25776.

Më 1968 këtu janë lexuar 34901 libra. Kurse, më 1971, ky numër bie në 33500 libra, 1401 më pak se më 1968 ose 4.1 për qind.

Më 1976 në Bibliotekë regjistrohen 3077 anëtarë. Gjatë periudhës 1976-1986, mesatarisht në vit, këtu janë regjistruar nga 2954 anëtarë, kryesisht studentë të Universitetit të Prishtinës. Ndërsa, mesatarisht në vit, janë lexuar nga 41834 njësi bibliotekare: libra e periodikë. Secili anëtar ka lexuar mesatarisht nga 14 njësi bibliotekare.

Përbërja sociale e përdoruesve të bibliotekës, gjatë periudhës 1976-1986, sillej 70 për qind studentë, 20 për qind profesorë e punëtorë të tjerë shkencorë e 10 për qind nëpunës e nxënës.

Gjatë kësaj periudhe, këtu, më se shumti është lexuar literatura nga mjekësia, teknika, bujqësia, sociologjia, drejtësia, matematika, fizika, kimia, biologjia, gjeografia, historia, filozofia, letërsia, gjuhësia etj.

Struktura e lexuesve të bibliotekave publike

Më 1959 bibliotekat publike (pa ato të komunës së Novobërdës e të Orllanit) kanë pasur 35904 lexues: 22106 nxënës ose 61.6 për qind, 3623 nëpunës ose 10 për qind, 2693 punëtorë ose 7.5 për qind, 6054 fshatarë ose 16.8 për qind e 1428 amvise ose 3.9 për

qind. Këtë vit bibliotekat e komunës së Glllogocit s'kanë pasur lexues nga radha e nëpunësve, punëtorëve e të amviseve, përkatësisht bibliotekat e komunës së Malishevës nuk kishin lexues nga radha e punëtorëve e të amviseve. Gjatë vitit 1959 lexuesit marrin në lexim 220847 libra: nxënësit 183806 ose 83.2 për qind, nëpunësit 29154 ose 13.2 për qind dhe amviset 7887 ose 3.5 për qind (1). Ndërkohë rritet numri i lexuesve dhe, më 1964, arrin në rreth 41000, 5096 më shumë se më 1959 ose 12.4 për qind. Më tepër se  $\frac{3}{4}$  e këtyre lexuesve kanë qenë nga radha e nxënësve e studentëve. Gjatë këtij viti janë lexuar 313802 libra, 277898 më shumë se më 1959 ose 88.5 për qind (2).

Shënimet më të plota i gjejmë më 1976. Këtë vit bibliotekat publike kanë tubuar 97977 lexues të regjistruar: fëmijë deri 14 vjeç 59368 ose 60.5 për qind, nxënës të shkollave të mesme e studentë 30375 ose 31 për qind, punëtorë nga prodhimi i drejtëpërdrejtë 2459 ose 2.5 për qind, punëtorë nga veprimtaritë e tjera 2485 ose 2.5 për qind, bujq 1831 ose 1.8 për qind dhe të tjerë 1459 ose 1.4 për qind. Më se shumti lexues, të të gjitha kategorive sociale, kanë pasur bibliotekat e komunës së Prishtinës 13692, ndërsa më se paku lexues kishin bibliotekat e komunës së Deçanit 702. Bibliotekat e Kamenicës s'kanë pasur lexues nga radha kategoria: të tjerë. Ndërsa bibliotekat e Leposaviqit s'kanë pasur lexues nga kategoria: punëtorë nga veprimtaritë e tjera.

Më 1976 janë lexuar 1503580 libra, ku prinin bibliotekat e komunës së Prishtinës me 394689 njësi.

Ndërsa e fundit ishte komuna e Prizrenit me 12202 njësi të lexuara. Në komunën e Prishtinës, secili lexues, ka lexuar, mesatarisht, nga 28.8 libra gjatë këtij viti (3).

Gjatë viteve 1967-1976 më se shumti janë kërkuar beletistika e gjuhësia. Librat më të kërkuara, sidomos gjatë viteve 1967-1968, kanë qenë “Afërdita” e Sterjo Spasse-s, “Sikur t’isha djalë” i Haki Stërmillit, “Karvani i bardhë” i Azem Shkrelit, “Dy rrëfime” të Ramiz Kelmendit, “Rrushi ka nisë me u pjekë” i Sinan Hasanit, “Mos u kthe, bir” i Arsen Dikliqit etj. Pason tevona literatura nga shkencat shoqërore, shkencat e aplikuara etj. Më se paku është kërkuar literatura me përmbajtje fetare 0.2 për qind dhe arti 2.7 për qind.

Në mbarim të vitit 1986, ndërkaq, bibliotekat publike kanë anëtarësuar 85999 lexues, 11978 më pak se më 1976 ose 13.9 për qind: 4554 punëtorë ose 5.2 për qind, 3133 bujq ose 3.6 për qind, 358 omvise ose 0.4 për qind dhe 3451 të tjerë ose 4 për qind. Në vitin 1986, 5.4 për qind e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë ka qenë e anëtarësuar në bibliotekat publike.

Në tri komuna s’ka pasur lexues nga radha e bujqve: Deçanit, Leposaviqit dhe Rahovecit, përkatësisht në shtatë komuna nuk kishte lexues nga radha e amviseve: Deçanit, Glllogocit, Kaçanikut, Kamenicës, Rahovecit, Skënderajt dhe Vushtrrisë. Ndërsa lexues nga kategoria: të tjerë s’kanë pasur bibliotekat e Deçanit, Istogut, Kamenicës, Lipjanit dhe Rahovecit.

Më 1986, në bibliotekat publike, janë lexuar 1213983 libra: nxënësit 1065327 ose 88 për qind, punëtorët

60495 ose 4.9 për qind, bujqit 40609 ose 3.3 për qind, amviset 7016 ose 0.5 për qind dhe: të tjerët 40536 ose 3.3 për qind.

Më 1986, krahasuar me numrin e librave të lexuara më 1976, është shënuar rënie e librave të lexuara për 289597. Rënie është shënuar në bibliotekat e Deçanit, Gjakovës, Istogut, Kaçanikut, Mitrovicës, Leposaviqit, Lipjanit, Rahovecit, Podujevës, Prishtinës, Skënderajt dhe Suharekës. Ndërsa rritje shënohet në bibliotekat e Dragashit, Glllogocit, Klinës, Pejës, Prizrenit, Ferizajt, Vitisë e Vushtrrisë. Me një fjalë, më se shumti libra për anëtar, mbi 10, janë lexuar në bibliotekat e Leposaviqit, Rahovecit, Mitrovicës, Pejës, Prishtinës, Dragashit, Kamenicës, Podujevës, Glllogocit, Suharekës, Prizrenit, Vushtrrisë, Gjilanit, Istogut, Lipjanit dhe Ferizajt. Ndërsa, nën 10 libra për anëtar, janë lexuar në komunën e Gjakovës, Skënderajt, Kaçanikut, Klinës, Deçanit e Vitisë (4).

Struktura kombëtare e lexuesve të bibliotekave publike

Më 1959 bibliotekat kanë pasur 35809 lexues të regjistruar: 15451 shqiptarë ose 43.1 për qind, 15774 serbë ose 44 për qind, 3507 malazez ose 9.7 për qind e 1077 të tjerë ose 3 qind.

Komuna e Zubin Potokut dhe e Shtërpçës s’kanë pasur lexues shqiptarë, përkatësisht Glllogoci, Suhareka e Shtërpca nuk kishin lexues malazez. Ndërkaq Vitia, Glllogoci, Zymi, Zubin Potoku, Klina, Kamenica, Lipjani, Podujeva, Skënderaj e Shtërpca nuk kanë

pasur lexues nga kategoria: të tjerë.

Më 1986 bibliotekat tubojnë 91693 lexues të regjistruar me këtë përbërje kombëtare: 64096 shqiptarë ose 69.9 për qind, 15897 serbë ose 17.3 për qind, 3326 malazez ose 3.6 për qind, 819 turq ose 0.8 për qind dhe 7555 nga kategoria: të tjerë ose 8.2 për qind.

Bibliotekat e komunës së Leposaviqit nuk kishin lexues shqiptarë, përkatësisht bibliotekat në Dragash, Glllogoc, Kaçanik, Kamenicë, Leposaviq e Vushtrri s'kanë pasur lexues malazez. Lexues turq kishte në bibliotekat e Gjilanit, Lipjanit, Mitrovicës, Prishtinës dhe të Prizrenit. Ndërsa në bibliotekat e Deçanit, Glllogocit, Kaçanikut, Leposaviqit, Rahovecit, Skënderajt e Vitisë s'kishte lexues nga kategoria: të tjerë.

Struktura e përdoruesve të bibliotekave universitare

Gjatë vitit studentesk 1985/86 bibliotekat universitare kanë pasur 43726 përdorues të regjistruar: 39631 studentë ose 90.6 për qind, 3300 profesorë ose 7.5 për qind dhe 795 të tjerë ose 1.8 për qind.

Më se shumti përdorues kanë pasur biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit Teknik, Degës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë, biblioteka e Degës së Kimisë, Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë, Fakultetit Juridik, Degës Filozofi-Sociologji, Degës së Historisë, Shkollës së Lartë Pedagogjike në Gjilan etj., ndërsa më se paku lexues kishin biblioteka

e Shkollës së Lartë Ekonomike Komerciale në Pejë, Fakultetit të Kulturës Fizike, Degës Gjuhë Frënge dhe Letërsi, Degës së Biologjisë, Degës së Gjeografisë etj. Më 1986, në bibliotekat universitare, janë marrë në lexim 111690 njësi monografike. Mesatarisht secili përdorues ka marrë në lexim nga 2.5 njësi bibliotekare. Më se shumti libra janë lexuar në Degën e Gjeografisë, Degën e Historisë, Degën e Pedagogjisë, Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Degën Filozofi-Sociologji, Degën e Matematikës, në SHLP Gjilan, SHLP Prizren, SHLP Gjakovë, Degën e Orientalistikës, Degën e Kimisë, në SHLP Prishtinë etj. Ndërsa më se paku libra janë lexuar në Degën e Biologjisë, Degën e Fizikës, në Qendrën e Arsimit të Lartë në Ferizaj etj.

Struktura sociale e lexuesve të bibliotekave shkollore

Gjatë vitit shkollor 1961/62, në 155 biblioteka shkollore (filllore e të mesme), të anketuara, kanë qenë të anëtarësuar 21428 vetë, 55.2 për qind shqiptarë. Këtë vit ata kanë lexuar 41518 libra: 15046 në gjuhën shqipe, 26155 në gjuhën serbokroatishte e 317 në gjuhën turke. Secili anëtar ka lexuar mesatarisht nga 1.9 libra (5). Në këtë periudhë, në këtë tip të bibliotekave, është lexuar sidomos beletristika për fëmijë. Fëmijët me ëndje lexonin Rexhep Hoxhën, Mark Krasniqin, France Bevkun etj.

Menjëherë bie në sy numri i vogël i librave të lexuara nga ana e nxënësve. Por duhet të kihet parasysh se një numër i mirë i nxënësve, në këtë periudhë, ka qenë i

anëtarësuar në bibliotekat publike. Po e zëmë, gjatë vitit 1961, 25596 nxënës kanë qenë anëtarë të këtyre bibliotekave, të cilët kanë lexuar 229103 libra.

Në vitin shkollor 1972/73, ndërkaq, 47 biblioteka të shkollave fillore, kanë pasur 17705 anëtarë: 16713 nxënës ose 94.3 për qind, 755 arsimtarë ose 4.2 për qind dhe 237 nga kategoria: të tjerë ose 1.3 për qind. Në këtë periudhë ata kanë lexuar 88457 libra: nxënësit 80010 ose 90.4 për qind, arsimtarët 7931 ose 8.9 për qind dhe 516 kategoria: të tjerë ose 0.5 për qind. Secili anëtar ka lexuar mesatarisht nga 4.9 libra. Po ashtu anëtarët kanë marrë në lexim edhe 15530 vëllime të periodikut: nxënësit 13204, arsimtarët 2061 dhe kategoria: të tjerë 265. Ndërsa 11 biblioteka të shkollave të mesme kanë pasë 7325 anëtarë: 6921 nxënës ose 94.4 për qind, 295 arsimtarë ose 4 për qind e 109 nga kategoria: të tjerë ose 1.4 për qind. Ata kanë lexuar 55133 libra: nxënësit 49736 ose 90.2 për qind, arsimtarët 4878 ose 8.8 për qind dhe kategoria: të tjerë 469 ose 0.8 për qind. Secili anëtar ka lexuar mesatarisht nga 7.5 libra. Të anëtarësuarit kanë marrë në lexim edhe 16071 vëllime të periodikut: nxënësit 13828, arsimtarët 2228 dhe kategoria: të tjerë 15 (6).

Më 1986, ndërkaq, 22 biblioteka të shkollave fillore kishin 27532 lexues: nxënës, arsimtarë e të tjerë. Ata kanë marrë në lexim 123141 libra: nxënësit 118383 ose 96.1 për qind, arsimtarët 4658 ose 3.7 për qind dhe kategoria: të tjerë 100 ose 0.08 për qind. Secili anëtar ka lexuar mesatarisht nga 4.4 libra. Ndërsa 11 biblioteka të shkollave të mesme kanë pasur 5577 lex-

ues: 5392 nxënës ose 96.7 për qind, 137 arsimtarë ose 2.4 për qind dhe 48 kategoria: të tjerë ose 0.8 për qind. Këta kanë lexuar 34369 libra: nxënësit 32664 ose 95 për qind, arsimtarët 1272 ose 3.7 për qind dhe kategoria: të tjerë 433 ose 1.2 për qind. Secili anëtar ka lexuar mesatarisht nga 6.1 libra.

<sup>1</sup>“Bilten Biblioteçkog Centra AKMO” -Prishtina, 1960, Broj II, f. 16

<sup>2</sup>“Nasha praksa”, Prishtina, 1965, 3-4, f. 12

<sup>3</sup>Vodiç kroz narodne biblioteke Jugoslavije, Beograd, 1979, f. 402-424. Numri i librave të lexuara në bibliotekat publike të komunës së Vitisë besohet të jetë 20067, jo sikurse ka dalë në burimin e cituar f. 422. Në numrin e librave të lexuara nuk janë përfshirë ato të komunës së Kamenicës.

<sup>4</sup>Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Vjetar statistikor për bibliotekat popullore të Kosovës për vitin 1986. Numri i lexuesve, të bibliotekave publike të komunës së Dragashit, është marrë nga gazeta “Rilindja” e datës 2.III.1986, f. 12

<sup>4</sup>“Nasha praksa”, Prishtina, 1962, Broj 2, f. 51. Me këtë rast janë

<sup>5</sup> anketuar 307 biblioteka ekzistuese shkollore, por anketës iu kanë përgjigjur vetëm 155 biblioteka

<sup>6</sup>“Zajednica biblioteka”, Beograd, 1975, 3, f. 77, 115, 120, 46-47, 110

### **KUADROT BIBLIOTEKARE DHE RREGULLIMI PROFESIONAL I BIBLIOTEKAVE**

**K**uadrot bibliotekare e rregullimi profesional i bibliotekave përbëjnë dy aspekte të rëndësishme të bibliotekave. Varësisht prej kuadrove bibliotekare, të aftësuar, në mënyrë profesionale bibliotekare, kreativ e të shkolluar, varet rregullimi profesional i koleksioneve të bibliotekave, të të gjitha tipave. Nga kjo, njëherit, varet edhe zhvillimi dhe avancimi i mbarë veprimtarisë së bibliotekave dhe i bibliotekarisë në përgjithësi.

Deri kah gjysma e viteve të gjashtëdhjeta, në bibliotekat tona, kanë dominuar kuadrot bibliotekare me shkollë fillore, kuptohet pa thirrje profesionale bibliotekare. Kështu, më 1964, në të gjitha bibliotekat, kanë punuar 57 punëtorë: 72.5 për qind me shkollë fillore e 27.5 për qind me shkollë të mesme. Prej këtyre 29 kanë qenë të përhershëm ose 50.8 për qind e 28 honorar ose 49.1 për qind.

Ndërkaq, më 1979, në biblioteka punonin 445 punëtorë bibliotekarë me këtë përgatitje shkollore: 71 me fakultet ose 15.9 për qind, 39 me shkollë të lartë ose 8.7 për qind, 310 me shkollë të mesme ose 69.6 për qind dhe 25 me shkollë fillore ose 5.6 për qind (1).

Siç shihet përgatitja e kuadrove me shkollë të mesme ishte e madhe, rreth 70 për qind, përkatësisht me shkollë fillore, rreth 6 për qind.

Më 1986, ndërkaq, në tre tipa të bibliotekave: Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Kosovës, bibliotekat publike dhe bibliotekat universitare kanë punuar 400 punëtorë bibliotekarë: 1 magjistër ose 0.2 për qind, 57 me fakultet ose 14.2 për qind, 34 me shkollë të lartë ose 8.4 për qind, 254 me shkollë të mesme ose 64.5 për qind e 54 me shkollë fillore ose 13.5 për qind. Prej këtyre 51 punëtorë e kanë pasur provimin profesional të bibliotekarisë ose 12.7 për qind.

Kuadrot bibliotekare të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës

Më 1962 kjo Bibliotekë kishte 11 punëtorë, kurse më 1967 ky numër arrin në 23 e më 1972 në 41. Më 1972, në krahasim me vitin 1962, numri i punëtorëve shtohet për 30 ose 73.1 për qind. Ndërkaq më 1984 Biblioteka ka pasur 148 punëtorë bibliotekare: 1 magjistër ose 0.6 për qind, 54 me shkollë të lartë ose fakultet ose 36.4 për qind. Në këtë periudhë, në Bibliotekë, dominonin kuadrot me shkollë të mesme.

Më 1986, ndërkaq, BPU e Kosovës ka pasur 145 punëtorë me këtë përgatitje shkollore: 1 magjistër ose 0.6 për qind, 36 me fakultet ose 24.8 për qind, 10 me shkollë të lartë ose 6.8 për qind, 75 me shkollë të mesme ose 51.7 për qind dhe 23 me shkollë fillore ose 15.8 për qind. Prej këtyre 46 punëtorë bibliotekarë kanë pasur provimin profesional të bibliotekarisë ose 31.7 për qind: 22 për librar ose 47.8 për qind, 2 librar të lartë ose 4.3 për qind dhe 22 bibliotekar ose 47.8 për qind.

Gjatë periudhës 1962-1981 në Bibliotekë janë pranuar 115 punëtorë sipas kësaj dinamike: 1962-4, 1964-5, 1965-4, 1966-1, 1967-1, 1968-3, 1969-2, 1970-6, 1971-4, 1972-4, 1973-1, 1974-6, 1975-9, 1976-9, 1977-6, 1978-11, 1979-32, 1980-3, 1981-4. Më së shumti punëtorë, gjatë kësaj periudhe, janë pranuar më 1979, gjithsej 32. Siç shihet më 1966, 1967 dhe 1973 janë pranuar nga një punëtor, 1969-2, 1968 dhe 1980 nga 3, 1962, 1965, 1971, 1972 dhe 1981 nga 4, më 1964-5, 1970, 1974 dhe 1977 nga 6, 1975 dhe 1976 nga 9, më 1978-11 dhe më 1979-32.

Struktura kombëtare e punëtorëve ka qenë: 83 shqiptarë ose 72,1 për qind, 27 serbë e malazezë ose 23,4 për qind dhe 5 të tjerë ose 4,3 për qind (2).

Kuadrot bibliotekare të bibliotekave publike

Më 1956, në bibliotekat publike, kanë punuar 72 punëtorë të rregullt me shkollë fillore katërklasëshe e më 1959 ky numër arrin në 105, 33 më shumë se më 1956 ose 31.4 për qind. Këto kuadro kanë pasur këtë

përgatitje shkollore: 33 me shkollë fillore katërklasëshe ose 31.4 për qind, 44 me shkollë fillore tetëklasëshe ose 41.9 për qind, 26 me shkollë të mesme ose 24.7 për qind dhe 2 me shkollë të lartë apo fakultet ose 1.9 për qind.

Më 1976 numri i punëtorëve profesionalë në biblioteka arrin në 164, 59 më shumë se në vitin 1959 ose 35.9 për qind me këtë përgatitje shkollore: 6 me fakultet ose 3.6 për qind, 9 me shkollë të lartë ose 5.4 për qind, 107 me shkollë të mesme ose 65.2 për qind e 42 me shkollë të ulët ose 25.6 për qind. Prej këtyre 24 punëtorë e kanë pasur provimin profesional të bibliotekarisë ose 14.6 për qind. Kuadrot profesionalë me fakultet kanë punuar në bibliotekat e komunës së Prishtinës e Ferizajt, ndërsa ato me shkollë të lartë në bibliotekat e komunës së Pejës, Gjilanit, Prishtinës e Mitrovicës. Ndërkaq kuadrot profesionalë, me provim të bibliotekarisë, kanë punuar në bibliotekat e komunës së Istogut, Leposaviqit, Lipjanit, Podujevës, Suharekës, Vushtrrisë, Glogocit, Gjilanit, Mitrovicës, Prishtinës, Prizrenit e të Ferizajt.

Më 1976 nuk janë shënuar ndryshime të mëdha kuadrosh prej një komune në komunën tjetër. Dallime hetohen te kuadrot me fakultet e shkollë të lartë. Kështu, vetëm dy biblioteka kanë pasur kuadro me fakultet: e Prishtinës dhe e Ferizajt, përkatësisht katër biblioteka kanë pasur kuadro me shkollë të lartë: e Gjilanit, Mitrovicës, Pejës dhe e Prishtinës. Në anën tjetër, kuadro pa provim profesional të bibliotekarisë, kishin bibliotekat e komunës së Deçanit, Gjakovës,

Dragashit, Kaçanikut, Klinës, Kamenicës, Rahovecit, Pejës, Skënderajt e të Vitisë.

Në mbarim të këtyre analizave, më 1986, në biblioteka kanë punuar 215 punëtorë bibliotekarë, 51 më shumë se më 1976 ose 23.7 për qind. Prej numrit të përgjithshëm të punëtorëve 199 kanë qenë të përherëshëm ose 92.5 për qind e 16 honorar ose 7.4 për qind. Ky kuadër kishte këtë përgatitje shkollore: 6 me fakultet ose 2.7 për qind, 17 me shkollë të lartë ose 7.9 për qind, 161 me shkollë të mesme ose 74.8 për qind e 31 me shkollë fillore ose 14.4 për qind. Kuadrot me fakultet e shkollë të lartë kanë punuar në bibliotekat e komunës së Prishtinës, Ferizajt, Vitisë, Dragashit, Gjilanit, Istogut, Klinës, Leposaviqit, Mitrovicës, Pejës dhe Suharekës. Krahasuar me vitin 1976, del se se kuadrot me fakultet kanë stagnuar dukshëm, ndërsa ai me shkollë të lartë ka shënuar rritje për 8 ose 47 për qind.

Kuadrot bibliotekare të bibliotekave universitare

Më 1986 bibliotekat universitare kanë pasur 40 punëtorë bibliotekarë: 35 të përherëshëm ose 87.5 për qind e 5 me honorar ose 12.5 për qind. Përgatitja shkollore e kuadrove ka qenë: 15 me fakultet ose 37.5 për qind, 7 me shkollë të lartë ose 17.5 për qind e 18 me shkollë të mesme ose 45 për qind. Kuadrot me fakultet kanë punuar në bibliotekën e SHLP-së në Prizren, bibliotekat e Degëve të Fakultetit Filozofik, bibliotekat e Degëve të Fakultetit të Shkencave Natyrore

Matematikore, bibliotekën e Fakultetit Teknik, Fakultetit të Arteve, Fakultetit të Bujqësisë dhe bibliotekën e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë. Ndërkaq kuadrot me shkollë të lartë kanë punuar kryesisht në bibliotekat SHLP-ve: Prishtinë, Pejë, Gjakovë e Gjiilan, në bibliotekën e Degës Gjuhë Serbokroatishte dhe Letërsi, bibliotekën e Fakultetit Juridik dhe në bibliotekën e Fakultetit Ekonomik.

Punët me honorar janë kryer në bibliotekën e Qendrës së Arsimit të Lartë në Ferizaj, bibliotekën e Degës së Historisë, Degës Gjuhë Ruse dhe Letërsi, Degës Gjuhë Angleze dhe Letërsi dhe bibliotekën e Degës së Biologjisë. Ndërkaq, punëtorët me provim profesional të bibliotekarisë kanë punuar në bibliotekën e SHLP-së në Prizren, SHLP-së në Prishtinë, SHLEK-së në Pejë dhe SHLP-së në Gjakovë.

Kuadrot bibliotekare të bibliotekave shkollore (fillore e të mesme)

Shënimet e para për gjendjen e kuadrove të angazhuar në bibliotekat shkollore i përkasin vitit shkollor 1961/62. Këtë vit, në bibliotekat shkollore, kanë qenë të angazhuar 52 punëtorë: 11 me orar të plotë ose 21.1 për qind dhe 41 me orar jo të plotë ose 78.8 për qind. Përgatitja shkollore e këtyre kuadrove ishte: 12 me fakultet ose 23 për qind, 25 me shkollë të lartë ose 48 për qind dhe 15 me shkollë të mesme ose 28 për qind. Vetëm dy punëtorë e kanë pasur provimin profesional të bibliotekarisë ose 3.8 për qind. Kuadrot me fakultet

kanë qenë të angazhuar kryesisht në bibliotekat e gjimnazeve, ndërsa ato me shkollë të lartë në bibliotekat e Qendrave shkollore. Ndërkaq, në bibliotekat e shkollave fillore ishin të angazhuara kuadrot me shkollë të mesme.

Më 1986, ndërkaq, në 26 biblioteka të hulumtuara: 18 të shkollave fillore e 8 të shkollave të mesme, kanë qenë të angazhuar 26 punëtorë: 18 me orar të plotë ose 69.2 për qind e 8 me orar jo të plotë ose 30.7 për qind. Përgatitja shkollore e këtyre kuadrove ishte: 11 me shkollë të lartë ose 42.3 për qind e 15 me shkollë të mesme ose 57.6 për qind. Asnjëri prej këtyre kuadrove nuk e ka pasur provimin profesional të bibliotekarisë.

Rregullimi profesional i koleksioneve të bibliotekave

Rregullimi profesional i bibliotekave në Kosovë nuk është bërë krahas me aspektet e tjera të bibliotekave: formimi e zgjerimi i rrjetit të bibliotekave, furnizimi i bibliotekave me material bibliotekar, shfrytëzimi i koleksioneve të bibliotekave etj.

Format e para të organizimit dhe rregullimit profesional të bibliotekave hasen qysh në vitet 1946-1948, fillimisht në bibliotekat publike, me ç'rast organizohen disa kurse për punëtorët e bibliotekave dhe sallave të leximit. Ndërkaq, gjatë periudhës kohore 1946-1956, janë mbajtur një numër kursesh, konsultash e seminaresh, me tema të ndryshme, nga puna dhe veprimtaria e bibliotekave, si në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Suharekë, Prizren, Gjiilan, Vushtrri,

Gjurakoc, Zveçan etj. Kështu, prej 12-25 korrik 1954, janë rregulluar rreth 30000 libra të bibliotekave publike në Prishtinë sipas KUD-it. Me këtë rast, në Prishtinë, sajohet edhe koleksioni i librave për huazim, koleksioni i librave shkencorë etj. Ndërkaq, gjatë viteve 1956-1966, në 40 biblioteka, kryesisht publike, zbatohet sistemi decimal dhe puna me skeda. Ndërkaq, në 5 biblioteka, me rreth 11000 libra, janë formuar edhe skedarët sipas alfabetit. Po ashtu janë organizuar 2 kurse profesionale për 42 vijues dhe janë dërguar jashtë Krahinës (Kosovës, shënimi ynë) 13 punëtorë bibliotekarë për aftësim. Në anën tjetër organizohen 3 këshillime profesionale për punëtorët bibliotekarë, përkatësisht 3 plenumë të Bashkësisë së Bibliotekave Amë të Krahinës, janë mbajtur 3 mbledhje profesionale me drejtorët e shtatë bibliotekave më të mëdha komunale, si dhe janë organizuar 5 mbledhje të Këshillit Krahinor të Bashkësisë së Bibliotekave Amë të Krahinës. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar edhe 62 referate për organet dhe organizatat e ndryshme krahinore, hartohen 3 propozime për rithemelimin e Bibliotekës Popullore Krahinore, bëhen 337 vizita profesionale në biblioteka, organizohen 2 anketa: një me fëmijë (mbi 800 të anketuar) e tjetra me punëtorë (mbi 2000 të anketuar), organizohen 75 biblioteka lëvizëse në sëndukë speciale, hartohen 20 punime, nga fusha e bibliotekave, për revistat e ndryshme profesionale etj. Bartëse e këtyre punëve bibliotekare, me qëllim të avancimit të tyre, kanë qenë sidomos Bashkësia e Bibliotekave Amë të Krahinës, punëtorët e Qendrës

Bibliotekare të Krahinës, Biblioteka Popullore e Krahinës etj (3).

Rregullimi profesional i koleksioneve të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës

Format e para të rregullimit profesional të kësaj biblioteke i gjejmë me rithemelimin e saj më 1962. Këtë vit këtu fillon inventarizimi e signaturizimi i librave të Bibliotekës. Sipas librave të inventarit kjo punë fillon më 30.05.1962. Njësia e parë e regjistruar në librat e pranimit, nga fondi i librit të falur, mban titullin: Industrijalizacija zhilishçnova stroitelstva e autorit N. Somo, botuar në Leningrad më 1935. Ndërkaq përpunimi i librit, nga fondi i kopjes së detyruar, fillon më 18.03.1965 me njësinë: Rat i mir, libri III-IV, i L.N. Tolstoit, botuar në Beograd më 1964.

Ndërkaq inventarizimi i librave të formatit II fillon më 1.8.1962, kurse ata të formatit I e III më 7.8.1962. Ndërkaq librat e formatit IV fillojnë të inventarizohen më 13.IX.1965 (4).

Më 31 dhjetor 1986, në depot e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës, kanë qenë të përpunuara e të depotizuara 225531 tituj të librave, përkatësisht signatura: formati I.729 libra e 325 doracakë, formati II 186803 libra e 3904 doracakë, formati III 30572 libra e 1183 doracakë dhe formati IV gjithsej 15 njësi: libra e doracakë.

Nga fondet e periodikut numërojmë, të përpunuara, 9784 tituj: 6888 të revistave e 2896 të gazetave.

Koleksionet e librit janë të depotizuara sipas sistemit numerus currens (numër vijues, që vihet si signaturë apo pjesë e signaturës së botimi). Po kështu është i vepruar edhe me periodikun, pa u ndarë sipas formatit.

Skedarët e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës

Në mbarim të vitit 1986 Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës ka pasur, në përdorim, katër lloje të skedarëve: tre të botimeve monografike: skedarin publik alfabetik me variantin intern, skedarin publik sistematik dhe skedarin intern topografik dhe një të periodikut: skedarin intern alfabetik. Biblioteka ka pasur edhe disa skedarë specialë.

**Skedari publik alfabetik.** – Fillimet i ka që nga rithemelimi i Bibliotekës më 1961. Është skedari themelor në Bibliotekë dhe më i përdorshmi. Është formuar sipas rregullave ndërkombëtare të përpunimit të botimeve monografike ISBD(M). Përcaktuesja e njësisë bibliotekare bëhet sipas alfabetit të gjuhës shqipe, kurse teksti i njësisë hartohet sipas gjuhës së botimit. Për botimet me alfabetin arab, kinez, japonez etj. bëhet transliterimi i përcaktueses në gjuhën shqipe. Renditja e skedave, në skedar, bëhet sipas alfabetit të gjuhës shqipe. Skedat janë të madhësisë 7.5 x 12.5 cm. Pos skedave kryesore skedari pasurohet edhe me skedat udhëzuese për koautorët, përkthyesit, ilustratorët etj. Në fund të viti 1986 skedari publik alfabetik kishte 420 kutia të madhësisë 14 x 4.5 cm. Varianti intern kishte 360 kutia.

**Skedari publik sistematik.** – Ka filluar të formohet në vitin 1962. Është pasqyrë reale e botimeve monografike të depotizuara në depot e Bibliotekës gjatë periudhës 1962-1986. Fillon me njësinë bibliotekare: Ljudska komedia, knj. 1-14 (odabrana djela) të Honore de Balzakut, Rijekë, 1960/1961 (II-1) dhe përfundon me njësinë: Letër nga zabeli : vjersha për fëmijë të moshës parashkollore të Rexhep Hoxhës, Prishtinë, 1983 (III-29323).

Në fund të vitit 1986 ka pasur 30 kutia.

**Skedari intern alfabetik i periodikut.** - Ka filluar të formohet në tetor të vitit 1973: i revistave, përkatësisht në shkurt të vitit 1978: i gazetave. Është formuar sipas rregullave ndërkombëtare të përpunimit të publikimeve serike (ISBD(S), përkatësisht rregullave të Klasifikimit Universal Decimal (KUD).

Në fund të vitit 1986 ky skedar kishte 59 kutia: 39 të revistave e 20 të gazetave. Varianti publik ka pasur 12 kutia.

Organizimi i brendshëm i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës

Më 31 dhjetor 1986 Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës ka pasur 11 seksione, 10 profesionale bibliotekarë. Ky organizim i punëve në Bibliotekë është formuar gjatë periudhës kohore 1962-1984.

**Seksioni i punëve të përbashkëta.** – Funkcionon në Bibliotekë që nga rithemelimi i saj më 1962. Kryen punët administrative-juridike në Bibliotekë.

**Seksioni për përparimin e veprimtarisë bibliotekare.** – Është formuar më 1962. Kryen funksionin amë për bibliotekat në Kosovë. Përcjell gjendjen dhe zhvillimin e rrjetit të bibliotekave në terren, sidomos atyre publike, të cilave iu ofron ndihmë profesionale. Është angazhuar rreth formimit të “Fondit B” (fondi i literaturës për bibliotekarinë). Ka bashkëpunuar në hartimin e publikimit Vodiç kroz narodne biblioteke Jugoslavije, Beograd, 1979. Prej 1983 organizon provimet profesionale bibliotekare.

**Seksioni i pasurimit të fondeve.** – Si referat ekziston prej 1962 në kuadrin e Seksionit të përpunimit të librit. Me këtë emër njihet prej vitit 1969. udhëheq politikën e furnizimit të Bibliotekës me material bibliotekar. Në kuadër të Seksionit punojnë edhe disa shërbime: shërbimi i ekzemplarit të detyruar, shërbimi i blerjes, shërbimi i këmbimit dhe i dhuratave etj.

**Seksioni për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit bibliotekar.** – Është formuar më 1962. Bën ruajtjen fizike të materialit bibliotekar dhe e jep atë në shfrytëzim sipas Ligjit mbi veprimtarinë e bibliotekave në Kosovë. Punët këtu kryhen përmes dy shërbimeve: shërbimit të sallave dhe shërbimit të depove. Mban edhe skedarin intern topografik dhe kryen edhe huazimin ndërbibliotekar.

**Seksioni i bibliografisë.** – Si referat figuron që nga 1962 në kuadrin e Përpunimit të Librit. Është pavarësuar më 1968. Harton tekste bibliografike, sipas rregullave ndërkombëtare bibliografike.

**Seksioni i periodikut.** - Fillimet i ka nga viti 1962. Si

Seksion i pavarur punon prej vitit 1973. Përpunon botimet serike të hyra në bibliotekë sipas standardeve rregullave ndërkombëtare. Prej vitit 1984 kryen edhe këmbimin e skedave me bibliotekat kombëtare në Jugosllavi. Njëherit plotëson skedarin alfabetik intern me skeda të reja të përpunuara.

**Seksioni për mbrojtjen dhe shumëzimin e materialit bibliotekar.** – Është formuar më 1969. Merret me restaurimin, konservimin, mikrofilmimin, shumëzimin dhe lidhjen e materialit bibliotekar të bibliotekës.

**Seksioni i skedarit alfabetik.** – Si referat ekziston prej vitit 1962, kurse është pavarësuar më 1977. Bën përpunimin e botimeve monografike sipas rregullave ndërkombëtare të ISBD(M)-it. Po ashtu plotëson skedarët e bibliotekës me skeda të përpunuara të publikimeve të reja. Bën edhe këmbimin e skedave, bashkë me ekzemplarët e detyruar, me bibliotekat e ngjashme të rajonit.

**Seksioni i skedarit sistematik.** – Prej vitit 1962 ekziston, si referat, në kuadër të Shërbimit të përpunimit të librit. Ndërsa është pavarësuar më 1977. Seksioni bën klasifikimin e librave sipas rregullave ndërkombëtare të KUD-it. Gjithashtu plotëson skedarët përkatës me skeda të reja të përpunuara. Që nga viti 1979 e avancoi veprimtarinë e vet duke e detajizuar klasifikimin në decimale e nëngrupe.

**Seksioni për informata shkencore dhe veprimtari referale.** – Është formuar më 1977. Jep informacione nga veprimtaria e tij profesionale.

**Seksioni i fondeve të veçanta.** – Është formuar në vitin 1984. Më 1986 këtu funksiononin dy referate: referati

i përpunimit të librit dhe i periodikut të vjetër e të rralë dhe referati i dorëshkrimeve të librave orientale.

Rregullimi i bibliotekave publike

Format e para të rregullimit profesional të bibliotekave publike hasen më 1948. Kështu, në gusht të këtij viti, organizohen dy kurse pesëmbëdhjetë ditëshe për punëtorët e bibliotekave publike dhe leximoreve në disa vendbanime të Kosovës. Ndërkaq, prej datës 12 deri më 25 korrik 1954, bëhet riorganizimi i koleksioneve të bibliotekës amë të Prishtinës me ç'rast inventarizohen, përpunohen, sipas Klasifimit Decimal Ndërkombëtar dhe vendosen në rafta rreth 30000 vëllime librash. Njëherit iu ofrohet ndihmë profesionale bibliotekare bibliotekave në Prizren, Suharekë, Pejë, Gjakovë, Zveçan, Vushtrri, Mitrovicë e Staritërg.

Ndërkaq, gjatë periudhës 1956-1966 rregullohen, po ashtu, sipas Klasifikimit Decimal, edhe 24 biblioteka në Viti, Kamenicë, Kaçanik, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Deçan, Suharekë, Skënderaj, Rahovec, Bllacë, Lipjan, Podujevë, Obiliq etj. Në disa prej këtyre bibliotekave formohen edhe skedarë alfabetikë dhe jipen udhëzime profesionale për formimin e tyre.

Në mbarim të vitit 1976, ndërkaq, 11 biblioteka kanë pasur në përdorim njërin prej skedarëve: alfabetik, sistematik, dhe sipas titujve: ajo në Dragash, Gjilan, Klinë, Kamenicë, Mitrovicë, Rahovec, Prishtinë, Skënderaj, Suharekë, Ferizaj e Viti. Vetëm biblioteka në Prishtinë i kishte në përdorim të tre skedarët: alfabetik,

sistematik dhe sipas titujve. Ndërsa pa skedarë kanë qenë biblioteka në Deçan, Gjakovë, Gillogoc, Istog, Kaçanik, Laposaviq, Lipjan, Pejë, Podujevë, Prizren e Vushtrri (5).

Thënë më saktë, këtë vit, bibliotekat kanë pasur në përdorim 16 skedarë: 9 alfabetikë, 5 sipas titujve e 2 sipas KUD-it. Shtatë biblioteka kanë pasur nga 1 skedar: e Dragashit, Gjilanit, Rahovecit, Skënderajt, Suharekës, Ferizajt dhe Vitisë, tri nga 2: e Klinës, Kamenicës dhe e Mitrovicës dhe një 3: biblioteka e Prishtinës. Skedarin alfabetik e kanë pasur biblioteka e Dragashit, Klinës, Kamenicës, Mitrovicës, Rahovecit, Prishtinës, Skënderajt, Suharekës dhe Ferizajt, kurse skedarin, sipas titujve, e kishin: biblioteka e Klinës, Kamenicës, Mitrovicës, Prishtinës dhe e Vitisë. Ndërkaq skedarin sipas KUD-it e kanë pasur biblioteka e Gjilanit dhe e Prishtinës.

Bartëse e këtyre punëve profesionale bibliotekare kanë qenë: Qendra Bibliotekare e KAKM-së, Biblioteka Popullore Krahinore, Këshilli Krahinor i Lidhjes së Enteve dhe Organizatave për Përhapjen e Librit etj.

Rregullimi i bibliotekave universitare

Rrjeti i bibliotekave universitare ka pasur një zhvillim njëkahësh: është zgjeruar mirë rrjeti i bibliotekave, por është lënë pas dore rregullimi profesional i koleksioneve të tyre. Me të drejtë thuhet se bibliotekat tona universitare sot funksionojnë "ekskluzivisht si servise të specializuara e të pavarura të procesit mësimor-shkencor

brenda institucioneve shkollore superiore, të cilat edhe i kanë themeluar. Në të vërtetë organet e fakultetit i trajtojnë si njësi teknike-administrative” (6). “Për më tepër mund të thuhet se jeta e një universiteti nuk mund të paramendohet pa bazën e tij shkencoro-mësimor, ku, në radhë të parë, bëjnë pjesë bibliotekat” (7).

Më 1986 bibliotekat universitare (të shkollave të larta e të fakulteteve) kanë pasur në përdorim 17 skedarë: 12 alfabetikë, 3 lëndorë e 2 sistematikë. Me një fjalë 12 biblioteka universitare nuk kanë pasur skedarë në përdorim ose 42.8 për qind.

Skedar alfabetik kanë pasur biblioteka e SHLP-së në Prishtinë e Degës së Gjeografisë, Degës së Historisë, Degës Filozofi-Sociologjisë, Degës së Matematikës, Degës Gjuhë Frënge dhe Letërsi e Fakultetit Juridik, Degës Gjuhë Serbokroatishte dhe Letërsi e Fakultetit Teknik. Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Mjekësisë dhe biblioteka e SHLP-së në Prizren. Ndërkaq skedarin lëndor e kanë pasur biblioteka e Degës Gjuhë Angleze dhe Letërsi e SHLP-së në Prizren dhe e Degës së Fizikës në Prishtinë. Ndërkaq skedarin sistematik e kishte biblioteka e Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë dhe biblioteka e SHLP-së në Gjakovë. Ndësa pa skedarë kanë qenë bibliotekat universitare: e Degës së Pedagogjisë, Degës së Orientalistikës, Degës së Kimisë, Degës Gjuhë Ruse dhe Letërsi, Degës së Biologjisë e Fakultetit të Arteve, Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë, Degës Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Fakultetit të Kulturës Fizike, SHLEK-së në Pejë, SHLP-së në Gjiilan dhe QAL në Ferizaj.

Depozitimi i koleksioneve bibliotekave është bërë kryesisht sipas sistemit numerus currens (numrit vijues), rreth 77 për qind, përkatësisht KUD-it 23 për qind.

Rregullimi i bibliotekave speciale

Fillimet e rregullimit profesional të këtyre bibliotekave hasen më 1946 me rastin e formimit të bibliotekës të Entit të Veterinarisë në Prishtinë, përkatësisht bibliotekës së Komitetit Shqiptar të Rrethit në Prizren, ndërsa, gjatë periudhës 1957-1967 është dalluar, për kah rregullimi profesiona, Biblioteka e Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë.

Në vitin 1979/1980 bibliotekat speciale në Kosovë kanë pasur 59 skedarë: 24 sipas alfabetit, 25 sipas titujve, 8 sipas KUD-it dhe 2 lëndorë. Me një fjalë 42 biblioteka kanë pasur 1 deri 3 skedarë. Nga 1 skedar e kanë pasur 28 biblioteka, nga 2 skedarë 11 dhe nga 3 skedarë kanë pasur 3 biblioteka.

Depozitimi i materialeve bibliotekare, të këtyre bibliotekave, është bërë rëndom sipas numerus currens-sit dhe KUD-it.

Rregullimi i bibliotekave shkollore (fillore e të mesme)

Bibliotekat shkollore kanë mbetur mbrapa, sa i përket rregullimit profesional të koleksioneve bibliotekare edhe pse biblioteka e shkollës, në teorinë bibliotekare, konsiderohet “organ i shkollës” (Branka Furlan). Në vitin shkollor 1961/62, në 40 për qind të bibliotekave

shkollore (më 1961 kanë qenë 288 biblioteka), nuk është bërë inventarizimi i librave në librat e inventarit, kurse vetëm 10 për qind e bibliotekave i kanë pasur të rregulluara koleksionet e tyre të librit sipas rregullave bibliotekare.

Ndërkaq më 1972/1973 vetëm 34 biblioteka, prej 234 sa kanë qenë më 1972, kanë pasur, në përdorim, ndonjë prej mënyrave bashkëkohëse të rregullimit të koleksioneve të librit ose 14.5 për qind. Nëntë biblioteka i kanë pasur të rregulluara fondet e librit sipas KUD-it, 19 sipas klasëve e 6 sipas ndonjë forme tjetër, kurse inventarizimin e librit, si dokument material i bibliotekës e kanë bërë 43 biblioteka. Në anën tjetër 24 biblioteka kanë mbajtur kartotekën e librave, përkatësisht 29 biblioteka, e mbanin kartotekën e lexuesve (8).

Ekziston shënimi se biblioteka publike e Prishtinës, rreth 1973, i ka rregulluar koleksionet librare të katër bibliotekave të shkollave fillore: "Vuk Karaxhiq", "Aca Maroviq", "Vladimir Nazor" e "Meto Bajraktari" të Prishtinës dhe të dy bibliotekave të shkollave të mesme: Shkollës së mesme të medicinës dhe gjimnazit "Ivo Ribar" të Prishtinës (9).

<sup>1</sup>Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Lidhja e Shoqatave Bibliotekare të Jugosllavisë, Raporti numër 105 (6.11.1980)

<sup>2</sup>Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë, 1984, f. 22-23; Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Spisak radnika NUB Kosova;

Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, Analitika A.P. 1986, Nr. i llog. 1-145

<sup>3</sup>Milan Jankoviq, Deset godina matične bibliotečke službe Kosova i Metrohije. "Bibliotekar", Beograd, 1966, broj 4, f. 348-352; Dymbëdhetë vjet zhvillimi kulturuar të Kosovë-Metohis, Prishtinë, 1957, f. 28

<sup>4</sup>Oblasna Narodna Biblioteka, Prijemni inventar poklonjenog fonda za godinu 1962 (1-231) i 1963 (1-3160); P.I. obaveznog primeraka knjiga 1965 (inv. br. 1-3940)

<sup>5</sup>Vodič kroz narodne biblioteke Jugoslavije, Beograd, 1979, f. 402-424

<sup>6</sup>Shkëlzen Maliqi, Univerzitetske biblioteke na Kosovu i njihova uključivanje u bibliotečki sistem. Deseta skupština Saveza drushtava bibliotekara Jugoslavije, Zagreb, 1985, f. 108

<sup>7</sup>Dragan Baraq, Zbornik propisa o bibliotekarstvu u SFRJ, Novi Sad, 1987, f. 22

<sup>8</sup>"Nasha praksa", Prishtina, 1962, Broj 2, f. 49; "Zajednica biblioteka", Beograd, 1975, 3, f. 92-95, 121; 64-68, 111; VSK-76, f. 330

<sup>9</sup>"Rilindja", 5.VII.1973, f. 9

## VEPRIMTARIA ARSIMORE E KULTURORE E BIBLIOTEKAVE

**A**spekt i rëndësishëm i veprimtarisë së bibliotekave është edhe karakteri i tyre arsimor e kulturor. “Një bibliotekë e mirë nuk duhet të jetë vetëm servis për të dhënë libra, por në të duhet të zhvillohet jetë dinamike e brendshme përmes formave të ndryshme të punës bibliotekare: ekspozitave, mbrëmjeve letrare, ligjëratave etj.” (1). Këtu duhet parë edhe veprimtarinë botuese-informative të bibliotekave, bashkëpunimin e tyre ndërbibliotekar etj.

Këto forma arsimore e kulturore janë të pranishme, në Kosovë, që nga viti 1948, qëllimin themelor të njëjtë e të përbashkët: afirmimin e librit e të bibliotekave. Kështu, në maj 1948, në Prishtinë e Mitrovicë, organizohet një ekspozitë e librave të botuesve nga Kroacia. Në Prishtinë kjo ekspozitë ka qëndruar e hapur më 11 e 12 maj, të cilën e vizitojnë rreth 3000 vetë: nxënës,

punëtorë, ushtarë e intelektualë.

Më se shumti ekspozita të librit janë organizuar gjatë viteve 1960-1964, rreth 140, të cilat i kanë vizituar 109636 vetë. Më 1963, kjo formë e fiton edhe një dimension të ri, të rëndësishëm: organizimin e ekspozitave shitëse (edhe në rrugë) me zbritje.

Ekspozitat organizohen rëndom gjatë mbajtjes së panairove të librit, “Muajit të librit”, me rastin e formimit të bibliotekave të reja, promovimit të botimeve të ndryshme etj.

Me këtë veprimtari kulturore, të ne, janë marrë kryesisht Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës dhe bibliotekat publike.

Veprimtaria arsimore e kulturore e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës

**Ekspozitat.-** Me organizimin e ekspozitave, kryesisht të librit e të periodikut, kjo bibliotekë, merret që nga viti 1964. Ekspozita të këtilla janë hapur edhe më 1977, 1980, 1982, 1983, 1984 etj. Kështu, në korrik 1977 BPU organizon ekspozitën me titull “Veprimtaria botuese në KSA të Kosovës”, e cila çelet në Muzeun e Kosovës. Një ekspozitë tjetër hapet në Itali (Kalabri e Sicili), në kuadër të “Javës së Kulturës Kosovare”, që zgjat prej 26.X-6. XI. 1980. Ndërkaq, më 1982, në lokalet e bibliotekës, me rastin e përrurimt solemn të këtij institucioni, hapet ekspozita me titull “Pasqyrë e veprimtarisë botuese në Kosovë 1945-1982, ndërsa, më 1.XI.1983, në bibliotekën “Matica Srpska”

të Novi Sadit, hapet ekspozita me titull “Veprimtaria botuese e kombeve dhe e kombësive të KSA të Kosovës”, me rastin: “Ditët e kulturës së Kosovës në Vojvodinë”, ku janë ekspozuar 400 tituj të librit e të periodikut të botuesve nga Kosova: “Rilindja”, “Jedinstvo” e “Tan”. Fjalën e rastit, këtu e ka paraqitur Bedri Hysa. Më 1984 organizohen tri ekspozita të rëndësishme. E para, me titull “Krijimtaria letrare e autorëve kosovarë”, hapet në nëntor, në lokalet e BPU të Kosovës, të cilën e çel poeti Esad Mekuli. Tjetra, me titull “Veprimtaria botuese e kombeve dhe e kombësive të Vojvodinës”, hapet në dhjetor 1984 me rastin: “Ditët e kulturës së Vojvodinës në Kosovë”. Këtë ekspozitë, e cila ka zgjatur prej 10 deri më 15 dhjetor e ka hapur Petko Vojniq-Purçar, kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Vjvodinës, i cili thotë: “Për këta 50 shekuj të ekzistimit të librit nga papirusi, dërrasave të bambusit, mëndafshit, pllakave të argjillit, pergamenës dhe letrës me galaksionin e Guttembergut-libri i ka lidhur njerëzit dhe popujt në kohë dhe kohën me njerëzit. Në të gjitha kohët dhe në të gjitha gjuhët libri flet për njeriun si individ dhe për njeriun si përfaqësues i shoqërisë, kështu që dëshmon për univesalitetin e fatit njerëzor në planetin tonë”. Në këtë ekspozitë paraqiten 900 tituj të librit e të periodikut në gjuhën serbokroatishte, hungareze, sllovaqe, rumune e rusine. Më 27.12.1984, në lokalet e BPU të Kosovës, çelet edhe ekspozita tjetër me titull “Dhurata e raritete” me rreth 250 eksponate: dorëshkrime, libra, harta gjeografike, mikrofilma, fotokopje, botime reprint të

dorëshkrimeve të vjetra dhe të librave, shirita të ndryshëm etj. Ekspozitën e ka hapur Rexhep Gashi, i cili ka thënë se kjo është një ekspozitë “e rrallë si për nga karakteri, ashtu edhe për nga përmbajtja e saj, sepse në të, nga fondi i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës, është ekspozuar ajo që është krijuar gjatë shekujve për këtë truall ose në këtë truall; është ekspozuar ajo që ka të bëjë me ato vlera kulturore-historike dhe shkencore të fjalës së shkruar”.

**Orët letrare.**- Me këtë aktivitet, kjo bibliotekë, është marrë pak, kryesisht për shkak të mungesës së lokalit. Por këtë e nis më 1983. Kështu, gjatë viteve 1983-1984, organizohen disa orë letrare, ku veçojmë atë të organizuar më 13.XII.1984, me rastin e manifestimit “Ditët e kulturës së Vojvodinës në Kosovë”, ku punimet e tyre letrare, i lexojnë 11 anëtarë të Shoqatës së Shkrimtarëve të Vojvodinës: Vera Benkova, Boshko Ivkov, Irina Hardi-Kovaçević, Petko Vojniq-Purçar, Karol Jung, Vojislav Despotov, Peter Kërdu, Miroslav Derbak, Filip Gabor, Nedelko Tërziq e Nenad Jurishiq.

**Ligjëratat.**- Ky aktivitet bibliotekar, këtu, fillon më 1974 dhe është organizuar rëndom nga BPU e Kosovës dhe Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës. Aktivitete të këtilla janë organizuar më 1974, 1975, 1983 etj. Në nëntor 1983 organizohet këshillimi me temën bosht: Sistemi unik bibliotekar-informativ në bibliotekarinë e Kosovës, ku, me kumtesa, paraqiten: Adem Bllaca, Mehmed Gërguri, Haxhi Vokshi, Sevdie Ahmeti, Tahir Foniqi, Muharrem Halili, Dragolub Petroviqi, Xhafer Sylja, Ismet Spahiu, Violeta Selimi e Radovan Kompiroviqi.

Në të njëjtën kohë, në BPU të Kosovës, si bashkorganizatore, janë organizuar edhe disa tribuna me tema për librin dhe çështjet e ndryshme rreth tij. Kështu, gjatë viteve 1983-1985, këtu, organizohen tribuna për përmbledhjen e poezive “Lum Lumi” të poetit Ali Podrimja, “Tokë e urtë” e Sërbolub Tasiqit, “A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit” të Sabri Hamitit, “Historia e letërsisë shqipe (Romantizmi I, II,) e Rexhep Qosjes, Esad Mekuli si përkthyes, Përkthimi si përshtatje etj. Në këto tribuna, me kumtesa e diskutime, janë paraqitur Ali Aliu, Sabri Hamiti, Vehap Shita, Sllobodan Kostiqi, Hasan Mekuli, Abdullah Karjagdiu, Radoslav Zllatanoviqi, Latif Berisha, Bajram Krasniqi, Petar Sariqi, Agim Vinca, Rrustem Berisha etj. Tribunat letrare i kanë organizuar Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, Shoqata e Përkthyesve të Kosovës”, shtëpitë botuese Rilindja, Jedinstvo etj.

**Veprimtaria botuese-informative e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës.** – Këtë veprimtari Biblioteka e ka nisë më 1959. Deri në mbarim 1986 kjo Bibliotekë ka botuar 11 botime: 2 serike e 9 monografike:

1. "Bilten", përkatësisht "Nasha praksa", Prishtina, 1959-1966, kryeredaktor Millan Jankoviqi, drejtor i Bibliotekës Popullore Krahinore 1 janar 1962-16 maj 1968
2. Një pasqyrë e veprimtarisë botuese në Kosovë = Pregled izdavačke delatnosti na Kosovu, Prishtinë, 1973
3. 30 vjet të veprimtarisë botuese në Kosovë = 30 godina izdavačke delatnosti na Kosovu, Prishtinë, 1975

4. Sevdie Ahmeti, Amedan Jani, Musa Gërguri, "Jeta e re" : Bibliografia : 1949-1974, Prishtinë, 1976, kryeredaktor Bedri Hysa, drejtor i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës 1 janar 1973-1 mars 1985
  5. Bibliografija "Stremljenja", Prishtina, 1980, hartuar Vladimir Bovani, Vladimir Cvetanoviç, Zoran Pavloviç, Dragolub Petroviç,
  6. Sevdie Ahmeti, Jeta e re : Bibliografia : 1975-1979, Prishtinë, 1980, kryeredaktor Bedri Hysa
  7. Katalogu i botimeve të huaja periodike në bibliotekat e Kosovës në vitin 1978 = Katalog stranih periodičnih izdanja u bibliotekama Kosova 1978. godine, Prishtinë, 1980
  8. "Biblioteka e Kosovës", kantatë e ekzekutuar me rastin e përrimit të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës më 25 nëntor 1982. Teksti: Bedri Hysa, muzika: Akil Koci, dirigjent: Mark Kaçinari, Prishtinë, 1982
  9. Udhërrëfyes = Vodiç, Prishtinë, 1982
  10. "Biblioteka", revistë, Prishtinë, 1984, kryeredaktor Bedri Hysa, sekretar i redaksisë Mr. Tahir Foniqi
  11. Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës = Narodna i univerzitetska Biblioteka Kosova = National and University Library of Kosova, Prishtinë, 1984, kryeredaktor Bedri Hysa.
- Ne kemi hetuar dy periudha kryesore të veprimtarisë botuese-informative të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës: 1959-1966 dhe 1973-1984.

Veprimtaria arsimore e kulturore e bibliotekave publike

**Ekspozitat.**- Kjo veprimtari fillon më 1952. Gjatë këtij viti biblioteka në Vushtrri organizon një ekspozitë të librave e cila qëndron e hapur për publikun gjashtë ditë. Me këtë rast atë e vizitojnë 600 vetë. Këtë vit edhe biblioteka në Mitrovicë ka organizuar ekspozitën lëvizëse të librave në vendbanimet Staritërg, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Sllatinë etj.

Ekspozita të librit organizohen pastaj edhe gjatë viteve 1955-1965 e 1976-1986 në Vushtrri, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan, Podujevë etj. Kështu, në tetor 1974 biblioteka në Gjilan hap ekspozitën me titull: "Libri në duart e punëtorëve". Ajo çelet në Kombinatin e Tekstilit dhe të Duhanit në Gjilan e cila qëndron e hapur prej 3 deri më 15 tetor. Atë e vizitojnë mbi 13000 punëtorë.

Gjatë vitit 1976 shtatë biblioteka komunale kanë organizuar 18 ekspozita të librit, të cilat i kanë vizituar 24519 vetë (2). Ndërkaq, gjatë periudhës 1978-1986, biblioteka e Prishtinës ka organizuar 17 ekspozita të librit me titull: "Çka lexojnë fëmijët e Bosnjës e Hercegovinës", "Çka lexojnë fëmijët e Kosovës", "Libri për moshën time" : ekspozitë për fëmijë e të rinj", "Java e imagjinatës", "Takimi i parë me bibliotekën e juaj", "Poezia revolucionare e poetëve tanë", "Shkrimtarët tanë për fëmijë", "Lektura juaj shkollore", "Poetët kosovarë" etj. Ekspozita "Çka lexojnë fëmijët e Bosnjës e Hercegovinës" ka qëndruar e hapur një javë. Këto ekspozita janë organizuar gjatë viteve 1978, 1981,

1984, 1985 e 1986 në Prishtinë, Llukar, Llapllasellë, Obiliq, Slivovë, Novobërdë, Breznicë etj. Të gjitha ekspozitat i kanë vizituar rreth 120000 vetë.

Gjatë viteve 1982, 1983, 1985 e 1986, po kaq ekspozita ka organizuar edhe biblioteka komunale në Mitrovicë, me titull: “Botimet me të reja në Kosovë”, “Vitrina e librit” etj.

**Orët letrare.**- Kanë filluar të mbahen më 1952. Po e zëmë, rreth këtij viti, biblioteka në Vushtrri, për çdo 15 ditë, organizonte mbrëmje letrare. Ndërkaq, më 1976, gjashtë biblioteka komunale kanë organizuar 110 orë letrare: e Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Vushtrrisë dhe e Klinës. Këto orë letrare i kanë ndjekur 14141 vetë (3). Edhe gjatë viteve 1978-1986, janë organizuar orë letrare, ku janë dalluar biblioteka komunale e Prishtinës, Mitrovicës, Gjakovës, Pejës etj. Ajo e Prishtinës ka organizuar orë letrare edhe në degët e saj në Keçekollë, Llukarë, Hade, Breznicë etj.

**Ligjëratat.**- Ka qenë praktikë dikur, që, gjatë “Muajit të librit”, që ishte një manifestim tradicional i përvjetshëm (tetor-nëntor), në shkolla, biblioteka e mese të tjera arsimore e kulturore, të organizoheshin ligjëratat, biseda, hartime e konkurse letrare, që, për temë e kishin fjalën e shkruar, librin e bibliotekat. Më 1962, bie fjala, në komunën Prizrenit e Gjakovës, të gjitha shkollat, ia kanë kushtuar nga një orë rolit edukativo-arsimues të librit. Me këtë rast janë mbajtur 54 orë, të cilat i kanë ndjekur 22900 vetë. Ndërkaq, gjatë viteve 1960-1963, mbahen 174 ligjëratat për librin, bibliotekat e shkrimtarët, të cilat i kanë përcjellë mbi

30000 vetë. Po ashtu janë shfaqur 64 filma për shkrimtarët, si dhe 250 diapozitiva me mendime për librin. Ndërsa, në gjashtë komuna, janë shpërblyer 45 hartime me temë mbi librin. Bartëse e këtyre aktiviteteve arsimore-kulturore kanë qenë, kryesisht, bibliotekat publike dhe Këshilli Krahinor i Lidhjes të Enteve dhe Organizatave për Përhapjen e Librit. Bibliotekat janë shpërblyer për këto aktivitete, më 1962, ajo e Prizrenit, Pejës dhe e Mitrovicës.

Kjo praktikë është ndjekur edhe më vonë. Kështu, gjatë viteve 1975-1978, biblioteka e Prishtinës, në degën e saj në “Ulpianë”, ka organizuar një cikël ligjëratash me interes për fëmijët, që kanë zgjatur nga një vit. Këtu fëmijët kanë marrë njohuritë e para për letërsinë, përkimet e letërsisë gojore me letërsinë imagjinative, letërsinë për fëmijë, zhvillimin e letërsisë për fëmijë, artin e shkrimit etj. Ligjëratat i kanë mbajtur poetët Vehbi Kikaj, Rexhep Hoxha, Rifat Kukaj dhe Çedo Shunjeviqi. Në anën tjetër, po kjo bibliotekë, më 1986, ka organizuar dy këshillime profesionale bibliotekare, për punëtorët bibliotekarë, rreth katalogimit (ISBD (M) dhe klasifikimit (KUD-it) të botimeve të hyra në bibliotekat ekzistuese. Biblioteka në Gjilan, më 1976, ka organizuar 18 ligjëratat, me tema arsimore e kulturore, të cilat i kanë ndjekur 870 vetë. Po ashtu edhe bibliotekat në Mitrovicë, Gjakovë e Pejë, më 1982, 1985 e 1986, organizojnë disa aktivitete e seminare me tema arsimore e kulturore bibliotekare.

**Bashkëpunimi ndërbibliotekar i bibliotekave (i të gjitha tipave).**- Bibliotekat i shquan edhe karakteri i

tyre ndërbibliotekar, ku bëhet këmbimi reciprok i vizitave e përvojave profesionale bibliotekare, materialeve bibliotekare, informatave profesionale e shkencore bibliotekare, literaturës profesionale bibliotekare etj.

Sipas hulumtimeve tona, me këtë segment bibliotekar, janë marrë tre tipa të bibliotekave: Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, bibliotekat publike dhe bibliotekat universitare. E para këtë e nis më 1962, kurse e avancon dukshëm rreth vitit 1975 e më vonë. Më 1982 kjo bibliotekë ka bashkëpunuar me rreth 200 biblioteka të rajonit, Evropës, SHBA-ve etj. Rreth vitit 1978, nga Shqipëria, kjo bibliotekë, merrte nga 5 kopje të secilit botim në Shqipëri (po kaq tituj merrte ajo nga kosova). Ndërkaq, gjatë vitit 1982, vetëm nga UNESCO, BPU e Kosovës ka marrë 86 tituj botimesh të ndryshme. Apo bibliotekat publike, më 1976, kanë bashkëpunuar me 12 biblioteka të rajonit, nga të cilat, janë huazuar 159 tituj botimesh dijesh O/9. Ndërsa bibliotekat universitare kanë bashkëpunuar me disa bibliotekat e ngjashme. Ekziston shënimi se biblioteka e Degës së Biologjisë, në Prishtinë, ka bashkëpunuar edhe me një bibliotekë të këtillë në Itali.

<sup>1</sup> "Bibliotekar", Beograd, 1967, 3-4, f. [204]

<sup>2</sup> Vodič kroz narodne biblioteke Jugoslavije, Beograd, 1979, f. 402-424

<sup>3</sup> Po aty, f. 402-424

## SHËNIME PËR AUTORIN

**M**r. Tahir Foniqi (Llaziçë e Llapushës, Kosovë, 1944) është shkrimtar, publicist e studiues i dalluar i bibliotekarisë. Punon në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Aktualisht është shef i Departamentit të Bibliografisë. Deri më tash ka botuar këto vepra:


E shoh në dritë (poezi), Prishtinë, 1973

Heshtja e një kohe (poezi), koautor, Tiranë, 1976

Mos e kërkoni në ëndrra (poezi), Prishtinë, 1983

Mbreti barbar (tregime), Prishtinë, 1987

Vdekja e Hanmit (tregime), Prishtinë, 1989



Emblema e vrerosur (poezi), Prishtinë, 1995  
 Dueti legjendar : Salih e Feriz Krasniqi (monografi), Prishtinë, 2000  
 Tema nga bibliotekaria, Prishtinë, 2003  
 Bibliografia e revistës Koha : 1978-1989, Prishtinë, 2004  
 Alush Qerratai (novelë), Prishtinë, 2004  
 Monografi për Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, koautor, Prizren, 2004  
 Si u bëra i anatemuar (publicistikë), Prishtinë, 2005  
 Dueti legjendar : Salih e Feriz Krasniqi, botim i dytë i plotësuar, Prishtinë, 2007  
 Kërkime bibliografike, Prishtinë, 2008  
 Tipat e bibliotekave në Kosovë, Prishtinë, 2008  
 Punimet e Tahir Foniqit janë botuar në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni, Slloveni, Zvicër, Suedi etj.

## PËRMBAJTJA

Parathënie	5
TIPAT E BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË	7
Formimi i rrjetit	7
Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës	9
Biblioteka Krahinore 1944-1952	10
Biblioteka Popullore Krahinore, përkatësisht Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës	14
Bibliotekat publike	17
Bibliotekat për fëmijë	29
Bibliotekat lëvizëse	30
Bibliotekat universitare	32
Bibliotekat e shkollave të larta	32
Bibliotekat e fakulteteve	34
Bibliotekat speciale	36
Biblioteka e Muzeut Krahinor	38
Biblioteka e Institutit Albanologjik të Prishtinës	39
Biblioteka e Fabrikës “Ramiz Sadiku” në Pejë	40
Biblioteka e Industrisë së Gomës dhe Kimike “Ballkan” në Suharekë	40

Biblioteka Qendrore e Lidhjes së të Verbërve të Kosovës	41
Bibliotekat shkollore (të shkollave fillore e të mesme)	42
STRUKTURA E KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKAVE	49
Struktura e koleksioneve të librit	50
Struktura e koleksioneve të librit të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës sipas KUD-it (Klasifikimi Universal Decimal)	50
Struktura e koleksioneve të librit të bibliotekave publike sipas gjuhëve	52
Struktura e librit të bibliotekave publike sipas KUD-it	55
Struktura e koleksioneve të librit të bibliotekave universitare sipas KUD-it	56
Struktura gjuhësore e koleksioneve të bibliotekave shkollore	56
Struktura e periodikut	57
Struktura e periodikut të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	57
Struktura e periodikut të bibliotekave publike sipas gjuhëve	59
Struktura gjuhësore e periodikut të bibliotekave universitare	60
Struktura e periodikut të bibliotekave shkollore (fillore e të mesme)	62
Koleksionet jolibër të bibliotekave (të të gjitha tipave)	62
STRUKTURA E PËRDORUESVE (LEXUESVE) TË BIBLIOTEKAVE	65
Struktura e përdoruesve të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	65
Struktura e lexuesve të bibliotekave publike	66
Struktura kombëtare e lexuesve të bibliotekave publike	69
Struktura e përdoruesve të bibliotekave universitare	70
Struktura sociale e lexuesve të bibliotekave shkollore	71
KUADROT BIBLIOTEKARE DHE RREGULLIMI PROFESIONAL I BIBLIOTEKAVE	75

Kuadrot bibliotekare të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	76
Kuadrot bibliotekare të bibliotekave publike	77
Kuadrot bibliotekare të bibliotekave universitare	79
Kuadrot bibliotekare të bibliotekave shkollore (fillore e të mesme)	80
Rregullimi profesional i koleksioneve të bibliotekave	81
Rregullimi profesional i koleksioneve të Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	83
Skedarët e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	85
Skedari publik alfabetik	84
Skedari publik sistematik	85
Skedari intern alfabetik i periodikut	85
Organizimi i brendshëm i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	85
Seksioni i punëve të përbashkëta	85
Seksioni për përparimin e veprimtarisë bibliotekare	86
Seksioni i pasurimit të fondeve	86
Seksioni për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit bibliotekar	86
Seksioni i Bibliografisë	86
Seksioni i periodikut	86
Seksioni për mbrojtjen dhe shumëzimin e materialit bibliotekar	87
Seksioni i skedarit alfabetik	87
Seksioni i skedarit sistematik	87
Seksioni për informata shkencore dhe veprimtari referate	87
Seksioni i fondeve të veçanta	87
Rregullimi i bibliotekave publike	88
Rregullimi i bibliotekave universitare	89
Rregullimi bibliotekave speciale	91
Rregullimi i bibliotekave shkollore (fillore e të mesme)	91
VEPRIMTARIA ARSIMORE E KULTURORE E BIBLIOTEKAVE	95

Veprimtaria arsimore e kulturore e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	96
Ekspozitat	96
Orët letrare	98
Ligjëratat	98
Veprimtaria botuese-informative e Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës	99
Veprimtaria arsimore e kulturore e bibliotekave publike	101
Ekspozitat	101
Orët letrare	102
Ligjëratat	102
Bashkëpunimi ndërbibliotekar i bibliotekave (i të gjitha tipave)	103
Shënime për autorin	105

MR. TAHIR FONIQI  
*TIPAT E BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË*  
 1944-1986

*Botues*

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Prishtinë

2008

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

02(496.51)1944/1986

027(496.51)1944/1986

Foniqi, Tahir

Tipat e bibliotekave në Kosovë :

1944/1986 / Tahir Foniqi. - Prishtinë : Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, 2008. - 111 f. ; 21 cm. - (BKUK : Botime të veçanta ; 13)

Parathënie : f. 5-6

ISBN 978-9951-13-035-6